


ALBANIAN ASSOCIATION OF BANKS  
SHOQATA SHQIPTARE E BANKAVE




raport vjetor

09

© Në këtë Raport janë përdorur fotografi të Shqipërisë të cilat janë marrë nga Agjencia Kombëtare e Turizmit dhe janë të mbrojtura me të drejtën e autorit. Është i ndaluar shumëzimi ose përhapja e tyre pa lejen e AKT-së.

Design & layout: Sonila Krashi  
Shtypi: Gent grafik

ALBANIAN ASSOCIATION OF BANKS  
SHOQATA SHQIPTARE E BANKAVE



raport vjetor **09**



Pamje nga Bregeti i Jonit.

## PËRMBAJTJA

• Mesazh i Kryetarit .....	7
• Rreth Nesh në 10 Vjet.....	8
• Profili i AAB-së .....	10
• Organigrama .....	10
• Komiteti Ekzekutiv i AAB-së.....	10
• Ndryshime Organizative Gjatë Vitit 2009 .....	11
• Sekretariati i AAB-së .....	11
• Sistemi Bankar Shqiptar Gjatë Vitit 2009 .....	13
• Aktiviteti i AAB-së Gjatë Vitit 2009 .....	15
I. Iniciativa Ligjore dhe Rregullatore.....	15
II. Çështje Operacionale Bankare .....	17
III. Aktiviteti i Komiteteve të AAB-së.....	19
IV. Pjesëmarrje dhe Evente të AAB-së .....	20
V. Promovimi dhe Marketingu .....	23
VI. Aktiviteti Financiar i AAB-së.....	25
• Profili i Bankave Anëtare .....	34



## MESAZH I KRYETARIT



*Të nderuar Kolegë,*

*Kam kënaqësinë t'ju drejtohem edhe këtë vit në cilësinë e Kryetarit.*

*Shoqata Shqiptare e Bankave ka vazhduar të arrijë rezultate të rëndësishme gjatë vitit 2009, një vit veçanërisht kompleks për Sektorin Financiar Ndërkombëtar dhe një nga periudhat më të vështira*

*të përjetuara nga Sistemi, e mbështetur fuqimisht nga suporti i vazhdueshëm e shumë i rëndësishëm i Stafit të Sekretariatit, Komitetit Ekzekutiv dhe të gjithë Anëtarëve.*

*Duke pasur mision fuqizimin e interesave të anëtarëve tanë, ne jemi përqendruar në disa çështje strategjike të cilat i kemi çuar drejt realizimit të plotë.*

*Do të përmendja në këtë rast vetëm disa nga çështjet ku janë realizuar arritje:*

- *Fondi dhe Premiumi i Sigurimit të Depozitave;*
- *Siguria fizike e Bankave;*
- *Çështje të Parandalimit të Pastrimit të Parave;*
- *Tarifat fiskale për shërbimet bankare;*
- *Bashkëpunimi me Autoritetin e Konkurrencës;*
- *Përmirësime në Rregullore dhe Raportime.*

*Gjithashtu, ne kemi organizuar evente, si konferenca, mbledhje, tryeza të rrumbullakëta, në të cilat janë aktivizuar pjesëmarrës të shumtë dhe të kualifikuar. Midis të tjerash, unë kam kënaqësinë të përmend Përvjetorin e 10-të të AAB-së celebruar bashkë me festat e fundvitit 2009, që ishte një shembull i suksesshëm i kompaktësisë së Sistemit.*

*Bashkëpunimi me Institucionet dhe Njësitë e tjera që veprojnë në mjedisin ekonomik ka pësuar gjithashtu rritje; jam krenar të përmend në mënyrë të veçantë bashkëpunimin me Bankën e Shqipërisë, që ka qenë i vazhdueshëm dhe i çmuar në interes të sektorit tonë.*

*Ne kemi një Sekretare të Përgjithshme të re të kualifikuar, staf profesional të dedikuar dhe Komitete teknike efektive.*

*Ka, padyshim, shumë objektiva të tjera për t'u arritur dhe duhet bërë akoma shumë në fushën strategjike të edukimit të qëndrueshëm financiar për bankierët shqiptarë; këto objektiva janë në fokusin e punës sonë.*

*Ju falënderoj përsëri dhe ju uroj suksese dhe prosperitet,*

*Me respekt,*

**Libero Catalano**  
Kryetar

## RRETH NESH NË 10 VJET

10 vjet më parë, në 31 Mars 1999, në një mbledhje miqësore, Drejtorët Ekzekutivë të nëntë bankave vendosën të krijonin në Tiranë Klubin e Bankierëve Shqiptarë. Themeluesit miratuan organigramën e Klubit, zgjodhën strukturën administrative dhe kryetarin e saj, dhe që prej atij momenti sistemi bankar shqiptar u përfaqësua denjësisht nga ky bashkim.

Në vitin 2001, me anëtarësimin e mëvonshëm në Klub të katër bankave të tjera anëtare, struktura administruese e Klubit të Bankierëve Shqiptar krijoi Shoqatën Shqiptare të Bankave (AAB), duke hartuar edhe statutin i cili përcaktonte që AAB do të përfaqësohej nga Kryetari i saj dhe Komiteti Ekzekutiv.

Që nga ajo kohë, thelbi i veprimtarisë dhe aktivitetit të AAB-së ka qenë arritja e misionit të saj në mbrojtjen dhe përfaqësimin e interesave të Anëtareve, rritjen e rolit të bankave tregtare në ekonominë shqiptare dhe promovimin e sektorit bankar shqiptar në mjedisin ndërkombëtar bankar.



Me kalimin e viteve, baza ligjore dhe organizative janë përmirësuar ndjeshëm. Statuti është rishikuar dhe përmirësuar në disa raste, me versionin më të fundit të aprovuar në vitin 2005, me ndryshime dhe shtesa të konsiderueshme, për funksionim më të mirë të Asamblesë, rritjen në pesë persona të numrit të anëtareve të Komitetit Ekzekutiv, përshkrimin më të mirë të detyrave të këtij Komiteti, si edhe krijimin e Sekretariatit dhe përcaktimin e përgjegjësive dhe detyrave të tij.

Krijimi i Sekretariatit të AAB-së dhe punësimi i Sekretarit të Përgjithshëm ishin hapa të rëndësishëm drejt krijimit të një institucioni

më profesional që vendosën themelet për një profil më të lartë të Shoqatës, sipas standardeve ndërkombëtare të shoqatave bankare.

Gjatë viteve, Shoqata ka ndërtuar një nivel të kënaqshëm transparence duke u shndërruar në një institucion të hapur për çdo palë të interesuar e duke përdorur metoda të ndryshme për të arritur transparencën, nga ato më klasiket, si publikimet, tek ato më modernet, si informacioni i përditësuar në internet. Duke filluar që nga Nëntori i vitit 2005, Sekretariati i AAB-së krijoi suksesshëm faqen e internetit të Shoqatës (në anglisht dhe shqip). Aktualisht, faqja e internetit përmban të dhëna të përditësuar mujore dhe tremujore, për sistemin bankar në total si dhe për bankat individuale.

Për një aktivitet më të përgjegjshëm dhe në përputhje me standardet e etikës brenda komunitetit bankar shqiptar, në vitin 2006, Asambleja e AAB-së aprovoi, në mënyre unanime, Kodin e Etikës Bankare. Përveç kësaj, AAB ka kontribuar për një profil me të theksuar social të sistemit bankar shqiptar, duke u përfshirë në nisma për mbledhje fondesh, siç ishte projekti “Bankat për Internetin në Shkollë”. Në zbatim të kësaj iniciative, të gjitha bankat kontribuuan me një shume të barabartë prej 3,000 Euro për të ndihmuar në krijimin e infrastrukturave të internetit në disa shkolla të mesme, si pjesë e projektit E-School të PNUD-it.

Në kuadrin e përpjekjeve të vazhdueshme të AAB-së për optimizimin e aftësive të veta organizative, Komiteti Ekzekutiv i AAB-së ka aprovuar krijimin e katër komiteteve të përhershëm nën kujdesin e AAB-së: Komiteti Juridik, Komiteti i Luftës Kundër Mashtrimit me Kartat, Komiteti i Sigurisë Bankare, dhe Komiteti i Sistemit të Pagesave. Këto janë komitete teknike që kane si qëllim të zgjidhin çështje të ndryshme bankare pa kosto shtesë, duke përdorur ekspertizën e brendshme të ofruar nga bankierë profesionalë.



## ANËTARËSIME DHE BASHKËPUNIME

Krahas bashkëpunimit të fortë me shoqatat bankare të vendeve fqinjë, në vitin 2003 AAB u bë “Anëtare e Asociuar” e Federatës Bankare Evropiane. Ky është një nga bashkëpunimet më të rëndësishme me organizatat bankare ndërkombëtare dhe ishte një hap i mëtejshëm drejt integritimit në strukturat e industrisë bankare Evropiane. AAB, si një Anëtare e Asociuar e FBE-së, mirëpriti dhe organizoi për herë të parë në Tiranë, mbledhjet e Komitetit Ekzekutiv dhe të Anëtarëve të Asociuar të FBE-së, në Qershor 2008.

Në vitin 2004, AAB së bashku me Shoqatat Bankare të rajonit firmosën një Memorandum Mirëkuptimi dhe themeluan një forum që pati si qëllim të ndihmonte biznesin bankar në rajonin e Ballkanit, i cili u quajt Forumi Ndërbalkanik i Shoqatave Bankare. AAB priti për herë të parë në Shqipëri, në Maj 2005, mbledhjen e radhës së këtij forumi në qytetin e Durrësit.

Që prej themelimit të saj dhe veçanërisht gjatë gjysmës së dytë të kësaj dekade, AAB e ka zgjeruar aktivitetin e saj si në drejtim të përmirësimit të legjislacionit ekonomiko-financiar për funksionimin më të mirë të sistemit bankar shqiptar, ashtu edhe në drejtim të bashkëpunimit me institucionet shtetërore dhe organizatat publike për zhvillimin ekonomik dhe integrimin e vendit në Bashkimin Evropian. Në lidhje me këtë mund të përmendim disa arritje:



AAB i dha një mbështetje themelore teknike dhe financiare Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për të krijuar e zhvilluar Regjistrin e Barrave Sigurorese. Në vitin 2007, Asambleja e AAB-së vendosi të financoje projektin me një shumë prej 3,000,000 Lekësh, duke hedhur kështu themelet për një bashkëpunim të frytshëm publiko-privat, si praktika më e mirë.

Krijimi i Zyrës së Informacionit të Kredive ka qenë padyshim një çështje shumë e rëndësishme dhe një sfidë për AAB-në dhe sistemin bankar. Sekretariati i AAB-së luajti një rol të rëndësishëm në zhvillimin e një diskutimi profesional mbi krijimin e kësaj njësie në Shqipëri dhe në sjelljen në vend të eksperiencës ndërkombëtare me teknologjinë e ruajtjes së të dhënave, veçanërisht nga EXPERIAN-SCOREX.

AAB, e përfaqësuar nga Sekretari i Përgjithshëm, është anëtare me të drejta të plota në Këshillin Konsultativ të Biznesit, i cili është një forum i vlefshëm për të përcjellë tek autoritet çështje të ndryshme, shqetësime, komente dhe propozime, që ndikojnë direkt ose indirekt në aktivitetin bankar shqiptar. Sekretari i Përgjithshëm i AAB-së është gjithashtu anëtar i Bordit Drejtues të Agjencisë së Zhvillimit të Zonave Malore.

Në bashkëpunim me Bankën e Shqipërisë dhe Programin “Convergence” të Bankës Botërore, AAB mbështeti krijimin e “SPI Albania (Iniciativa për Projekte Speciale), që u bë efektive nga Maji 2008, si një nismë e bashkëpunimit publik-privat, me objektiv modernizimin e sistemit financiar shqiptar, nëpërmjet zhvillimit të një kulture dialogu dhe ndërtimit të konsensusit.


Shoqata jonë është rritur ndjeshëm gjatë dhjetëvjeçarit të saj të parë, megjithatë, ne jemi të ndërgjegjshëm që përpjekje dhe angazhim më i madh kërkohen në të ardhmen.

Në këtë kontekst, ne mbetemi shumë të dedikuar që të zhvillojmë më tej kapacitetin organizativ dhe funksionimin profesional të AAB-së.

## PROFILI I AAB-SË

**Forma Juridike:** Organizatë Jo-Fitimprurëse  
**Anëtarësia:** 16 Banka Tregtare (vullnetare)

## ORGANIGRAMA



## KOMITETI EKZEKUTIV I AAB-SË



Z. Libero CATALANO  
Drejtor Ekzekutiv  
Veneto Banka  
Kryetar i Komitetit Ekzekutiv



Z. Oliver WHITTLE  
Drejtor Ekzekutiv  
Raiffeisen Bank  
Nënkryetar i Komitetit Ekzekutiv



Z. Borislav KOSTADINOV  
Drejtor Ekzekutiv  
Procredit Bank  
Anëtar



Z. Gazmend KADRIU  
Drejtor Ekzekutiv  
Union Bank  
Anëtar



Z. Ioannis KOUGIONAS  
Drejtor Ekzekutiv  
Banka Kombëtare e Greqisë  
Anëtar

## NDRYSHIME ORGANIZATIVE GJATË VITIT 2009

Në Mbledhjen e Asamblesë së Anëtarëve të AAB-së, që u mbajt në 26 Janar 2009, u zhvilluan dy raunde zgjedhesh: zgjedhja e dy pjesëtarëve të rinj të Komitetit Ekzekutiv të AAB-së dhe zgjedhja e Kryetarit të ri të AAB-së.

Asambleja zgjodhi Z. Borislav Kostadinov, Drejtor i Përgjithshëm i Bankës ProCredit, dhe Z. Gazmend Kadriu, Drejtor i Përgjithshëm i Union Bank, si dy anëtarë të rinj të Komitetit Ekzekutiv.

Gjithashtu, Asambleja zgjodhi unanimisht Z. Libero Catalano, Drejtor i Përgjithshëm i Veneto Banka, si Kryetarin e ri, dhe Z. Oliver Whittle, Drejtor i Përgjithshëm i Bankës Raiffeisen – Shqipëri, si Zëvendës Kryetar të AAB-së.

Një raund tjetër zgjedhesh për anëtarësim në Komitetin Ekzekutiv u zhvillua në mbledhjen e Asamblesë së Anëtarëve të datës 14 Dhjetor 2009, si vijim i dorëheqjes nga pozicioni i anëtarit të Z. Abdul Waheed Alavi, i cili la detyrën e tij si Drejtor i Përgjithshëm i Bankës së Bashkuar të Shqipërisë. Z. Ioannis Kougionas, Drejtor i Përgjithshëm i Bankës Kombëtare të Greqisë, u zgjodh anëtar i Komitetit Ekzekutiv të AAB-së, me mandat dy vjeçar.

Në Tetor, pas një procesi seleksionimi të plotë dhe transparent, nën angazhimin e plotë të Komitetit Ekzekutiv të Shoqatës, Znj. Endrita Xhaferaj u emërua Sekretarja e re e Përgjithshme e AAB-së.

## SEKRETARIATI I AAB-SË



Znj. Endrita XHAFERAJ  
SEKRETARE E PËRGJITHSHME

Znj. Junida KATROSHI  
ASISTENTE

Znj. Brunilda KOSTARE  
KËSHILLTARE LIGJORE



## SISTEMI BANKAR SHQIPTAR GJATË VITIT 2009



Gjatë vitit 2009, sistemi bankar shqiptar u përball me një situatë sfiduese dhe u ndikua nga zhvillimet makroekonomike në shtetet partnere, si edhe në mjedisin e brendshëm ekonomik, por mbeti gjithsesi në stabilitet dhe fitimprurës. Bankat shqiptare kanë pak ose fare ekspozim të drejtpërdrejtë ndaj aseteve apo njësive të njohura si problematike në arenën ndërkombëtare, kryesisht si rrjedhojë e strukturës së thjeshtë të burimeve të tyre, ku depozitat në përgjithësi dominojnë dhe financimi i jashtëm është i kufizuar.

Edhe pse me një ritëm të ngadaltë, asetet e sistemit bankar vazhduan të rriten gjatë vitit 2009, në terma nominale por edhe në terma relativë, si kontribut në Produktin e Brendshëm Bruto. Krahasuar me vitin 2008, gjatë vitit 2009, asetet totale të bankave u rritën me rreth 6.25 për qind, duke arritur në 77.5 për qind të PBB-së në vend.

Depozitat e tërhequra në periudhën mes fundit të vitit 2008 dhe fillimit të vitit 2009 u rikuperuan plotësisht, si rezultat i rikthimit të besimit të publikut dhe stabilizimit të situatës.

Aktiviteti i huadhënies përbënte rreth 51 për qind të aseteve të sistemit në Dhjetor 2009. Pavarësisht ngadalësimit të ndjeshëm gjatë vitit 2009, veçanërisht gjatë tremujorit të dytë, kreditë e dhëna nga sistemi bankar u rritën me rreth 13.4 për qind krahasuar me ato në vitin 2008, duke u llogaritur kështu në rreth 39.3 për qind të PBB-së. Gjithashtu, bankat kanë rritur në mënyrë të vazhdueshme kredidhënien në monedhën vendase.

Huat me probleme janë rritur gjatë vitit, duke përkeqësuar përfitueshmërinë e bankave, si pasojë e rritjes së ndjeshme të shpenzimeve për provigjionimin e kredive. Megjithatë, rezultati neto i sistemit për vitin 2009 vazhdoi të ishte pozitiv në shumën 3.54 Miliardë Lekë.

**Tabela I. Tregues të performancës së sistemit bankar shqiptar**

Tregues	2008	2009
Asetet Totale (Miliardë Lekë)	834.1	886.3
në % të PBB-së	76.7 %	77.5 %
Depozitat Totale (Miliardë Lekë)	645.1	694.3
në % të PBB-së	59.3%	60.7%
Kredi të Ekonomisë (Miliardë Lekë)	396.9	449.4
në % të PBB-së	36.5%	39.3%
Kapitali i Aksionerëve (Miliardë Lekë)	71.5	84.8
Fitimi (Miliardë Lekë)	7.34	3.54

*Burimi: Banka e Shqipërisë*

Sistemi bankar shqiptar vazhdoi të qëndronte i mirëkapitalizuar dhe likuid gjatë vitit 2009. Niveli i mjaftueshmërisë së kapitalit për sistemin ishte 16.17 për qind në Dhjetor 2009, ndjeshëm mbi nivelin minimal prej 12 për qind.

Treguesi “kredi ndaj totalit të depozitave” u rrit në 65 për qind në fund të vitit 2009, por vazhdon të jetë i ulët krahasuar me rajonin apo me BE-në, çka tregon se sektori bankar ka akoma kapacitet të mjaftueshëm të rritet, pa u mbështetur në mënyrë të rëndësishme në financimin nga jashtë.

Gjatë vitit 2009, Qeveria shqiptare shiti aksionet që mbante tek Banka e Bashkuar e Shqipërisë duke bërë kështu që në fund të vitit 2009, sistemi bankar të ishte plotësisht i privatizuar. Rritja e kapitalit të aksionarëve në pjesën më të madhe të bankave dhe ndryshimet strukturore në kapitalin e tyre, u reflektuan në një rritje të dominimit të kapitalit të huaj (92.3 për qind të totalit të kapitalit të sistemit në fund të vitit 2009). Kapitali me origjinë nga Bashkimi Evropian përfaqëson pjesën dërrmuese të kapitalit të sistemit, rreth 75.5 për qind.

Bankat vazhduan të zgjerojnë aktivitetin e tyre me rritjen e numrit të degëve dhe agjencive në territorin e Shqipërisë në vitin 2009, si edhe numrin e ATM-ve dhe POS-eve, duke iu ofruar klientëve mundësinë e përdorimit të më shumë shërbimeve dhe produkteve financiare.

**Tabela 2. Rrjeti i Bankave**

<b>Tregues</b>	<b>2008</b>	<b>2009</b>
Nr. i Degëve dhe Agjencive	517	533
Nr. i ATM-ve	642	741
Nr. i POS-eve	2,953	4,370
Nr. i Kartave	512,232	566,985
- Debiti	482,072	543,141
- Krediti	15,931	23,844

*Burimi: AAB dhe Banka e Shqipërisë*

Duke filluar nga Qershori 2009, Bankat futën në përdorim numrin ndërkombëtar të llogarisë bankare (IBAN), si për pagesat në vend ashtu edhe për ato ndërkombëtare, duke iu ofruar klientëve të tyre të gjitha lehtësitë për përdorimin e tij.

## AKTIVITETI I AAB-SË GJATË VITIT 2009



### I. INICIATIVA LIGJORE DHE RREGULLATORE

#### i. KUADRI LIGJOR PËR SIGURIMIN E DEPOZITAVE

Në Mars të vitit 2009 Parlamenti Shqiptar aprovoi ndryshime dhe amendime të Ligjit “Për Sigurimin e Depozitave”, që kishin të bënin me rritjen e kufirit maksimal të sigurimit të depozitave nga 700.000 Lekë në 2.500.000 Lekë. Kjo masë erdhi në momentin e duhur, kur ekonomia globale ishte duke përjetuar një nga krizat më të vështira ekonomike dhe financiare, duke lehtësuar efektet psikologjike që kishin filluar të influenconin depozitat bankare, duke ofruar kështu më shumë siguri për depozituesit.

AAB organizoi disa mbledhje teknike me përfaqësues të bankave dhe Bankës së Shqipërisë, mbi pasojat e këtyre ndryshimeve në ligj. Madje, Kryetari i AAB-së mori pjesë në një seancë të Komisionit Parlamentar për Çështjet Ekonomike, që i dedikohet ndryshimeve dhe amendimeve në ligjin “Për Sigurimin e Depozitave”. Falë aktivitetit të AAB-së, efektet ekonomike të Ligjit (pra, pagesa e premiumit të llogaritur mbi shumën e re të depozitave të siguruara) u shtynë deri në vitin 2010, duke lënë detyrimet për premiumin për vitin 2009, të pandryshuara.

Në vazhdim, AAB dhe Agjencia e Sigurimit të Depozitave (ASD) ndërmorën disa veprime të koordinuara për tu shprehur publikisht në lidhje me ndryshimet në ligjin “Për Sigurimin e Depozitave”. Dy institucionet përgatiten një letër të përbashkët e cila iu dërgua kompanive të mëdha, me kërkesën për të bashkëpunuar në organizimin e takimeve për informimin e stafit të tyre. Sekretariati i AAB-së koordinoi punën me ASD-në për shpërndarjen në kohë të broshurave të reja të informacionit në degët dhe agjencitë e të gjitha Bankave, si dhe në pikat kufitare kryesore. ASD organizoi në mënyrë të vazhdueshme, me mbështetjen e AAB-së, forume të hapura dhe takime me depozituesit përgjatë gjithë gjysmës së dytë të vitit 2009.

Një nga çështjet më në fokus të punës së Komitetit Ekzekutiv të AAB-së përgjatë gjysmës së dytë të vitit ishte zvogëlimi i impaktit në kosto të ndryshimeve të Ligjit “Për Sigurimin e Depozitave”. Sekretariati i AAB-së krijoi një grup pune me ekspertët e të gjitha Bankave. Në vijim të diskutimeve dhe kontributit të dhënë nga mbledhjet e këtij grupi, Sekretariati i AAB-së përgatiti një material të detajuar për të argumentuar dhe mbështetur propozimin drejtuar Autoriteteve Përkatëse, për të konsideruar një metodë të re për llogaritjeje të Premiumit të Sigurimit të Depozitave. Ky material iu dërgua autoriteteve gjatë vitit 2010 dhe diskutime të mëtejshme priten që të zhvillohen.

#### ii. KUADRI RREGULLATOR PËR PARANDALIMIN E PASTRIMIT TË PARAVE

Në Shkurt të vitit 2009 hyri në fuqi Udhëzimi Nr. 12 “Për metodikat dhe procedurat e raportimit të subjekteve raportuese” që pasoi Ligjin Nr. 9917 datë 19.05.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, nga Drejtoria e Përgjithshme për Parandalimin e Pastrimit të Parave (DPPPP). Sekretariati i AAB-së organizoi një mbledhje me ekspertë nga të gjitha bankat

anëtare në lidhje me zbatimin praktik të dispozitave të veçanta të këtij Udhëzimi nga bankat, në kuadrin e përcaktimeve dhe detyrimeve të përgjithshme të këtij ligji. Një grup pune i përbashkët u krijua, me përfaqësues nga bankat, Banka e Shqipërisë dhe DPPPP, që rishikuan klauzolat konfliktuale të udhëzimit. Në vijim të diskutimeve të grupit të punës, Sekretariati i AAB-së përgatiti një material të konsoliduar drejtuar DPPPP-së me propozimet për ndryshime të udhëzimit.

DPPPP është ende duke i rishikuar dhe konsideruar këto propozime, dhe pritet që komentet dhe sugjerimet e AAB-së të merren në konsideratë, së bashku me ato të pjesëtarëve të tjerë të tregut financiar, si institucionet financiare jo banka, të cilat janë palë të interesuara të këtij Udhëzimi.

Ndërkohë, AAB ndërmori një iniciativë për rishikimin dhe ndryshimin e mundshëm edhe të vetë Ligjit “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”.

Duke pasur në konsideratë ndjeshmërinë dhe rëndësinë e kësaj çështje, Sekretariati i AAB-së organizoi një mbledhje me përgjegjësit për përputhshmërinë me kuadrin rregullativ të çdo banke, e cila u pasua nga një tjetër mbledhje e Komiteti Juridik të AAB-së. Në vazhdim të këtyre mbledhjeve, Sekretariati dërgoi tek DPPPP (si dhe tek Ministria e Financave dhe Banka e Shqipërisë) një propozim për rishikimin e Ligjit, kryesisht në lidhje me nenin 27, i cili parashikon një penalizim me 10 për qind deri në 50 për qind të shumës për transaksionet e paraportuara nga bankat.

### iii. RREGULLORJA E BANKËS SË SHQIPËRISË MBI RREZIKUN NGA EKSPOZIMET E MËDHA TË BANKAVE

Gjate fundit të vitit 2008, Banka e Shqipërisë aprovoi disa ndryshime të Rregullores “Për administrimin e rrezikut nga ekspozimet e mëdha të bankave”, e shtyrë nga situata dhe problemet me të cilat po ndeshesh në atë kohë sistemi bankar botëror. Pika më e ndjeshme për Bankat ishte ulja e limitit total të transaksioneve (kryesisht vendosjeve) me bankat mëmë dhe filialet, nga 25 për qind në 10 për qind të kapitalit rregullator të bankave.

Duke konsideruar përmirësimet e ndjeshme të bankave, dhe faktin që pjesa më e vështirë e krizës ka kaluar, AAB iu drejtua Bankës së Shqipërisë me kërkesën për të marrë në konsideratë rishikimin e mundshëm të kësaj rregulloreje në lidhje me limitet dhe mënyrat e llogaritjes së ekspozimit ndaj bankave mëmë.

### iv. RREGULLORJA E BANKËS SË SHQIPËRISË MBI SIGURINË E BANKAVE

Në fund të vitit 2008, të gjitha bankave anëtare iu ishte dërguar Rregullorja Nr. 91 e Bankës së Shqipërisë, datë 24.12.2008 “Për kushtet minimale teknike dhe të sigurisë të mjediseve në të cilat kryhen veprimtaritë bankare dhe financiare”, dhe gjatë vitit 2009 ato filluan të plotësonin kushtet e përcaktuara në të. Ndërkaq, bankat identifikuan disa probleme që e bënin të vështirë ose të pamundur zbatimin praktik të kësaj rregulloreje, probleme kryesisht të lidhura me detaje tërësisht teknike, të cilat mund të mos jenë të aplikueshme në të gjitha degët dhe agjencitë e bankave.

Bazuar në diskutimet dhe komentet e Komitetit të Sigurisë Bankare të AAB-së, Sekretariati përgatiti një material të hollësishëm me sugjerime dhe propozime në lidhje me ndryshimet përkatëse të rregullores, që iu transmetua Bankës së Shqipërisë.

Departamenti i Sigurisë në Bankën e Shqipërisë u angazhua të rishikojë rregulloren dhe të marrë në konsideratë sugjerimet e bëra nga AAB. Për diskutime të mëtejshme mbi këtë çështje, AAB organizoi një mbledhje, gjatë vitit 2010, me përfaqësues të Bankës së Shqipërisë dhe anëtarë të Komitetit të Sigurisë së AAB-së.



## II. ÇËSHTJE OPERACIONALE BANKARE

### i. AUTOFATURIMI I TVSH-SË PËR SHËRBIMET BANKARE

Që prej vitit 2008, AAB pati organizuar diskutime të detajuara me Bankat Anëtare dhe Ministrinë e Financave, në lidhje me autofaturimin e TVSH-së për shërbimet bankare, dhe pati përgatitur dhe propozuar për Ministrinë e Financave një listë shërbimesh bankare, të cilat mund të përjashtohen nga aplikimi i autofaturimit të TVSH-së.

Puna e kryer për këtë çështje nga AAB rezultoi e suksesshme dhe përfundimisht, Ministri i Financave miratoi në Shkurt 2009, nëpërmjet një shkrese zyrtare, listën e shërbimeve, të propozuar nga AAB, të cilat janë praktikisht të përjashtuara nga aplikimi i autofaturimit të TVSH-së. Kështu, shpenzimet operative të bankave ulen në një masë të konsiderueshme.

### ii. PROJEKT MARRËVESHJA E BASHKËPUNIMIT MIDIS BANKËS SË SHQIPËRISË DHE BANKAVE TË HUAJA

Gjatë verës së vitit 2009, Sekretariati i AAB-së përktheu dhe shpërndau për mendim tek Bankat Anëtare një projekt marrëveshje bashkëpunimi mes BSh-së dhe Bankave të Huaja që veprojnë në Republikën e Shqipërisë. Në vijim, Sekretariati përgatiti një material që përmblihte gjithë opinionet dhe komentet mbi projekt marrëveshjen, të ardhura kryesisht nga kompanitë mëmë dhe aksionerët e huaj në bankat lokale, të cilin ia paraqiti Departamentit të Mbikëqyrjes së BSh-së, për përgatitjen e draftit final të marrëveshjes.

### iii. RAPORTIMI NË BANKËN E SHQIPËRISË

Sekretariati i AAB-së organizoi dhe koordinoi disa mbledhje teknike me Departamentin e Mbikëqyrjes së BSh-së dhe përfaqësues të Bankave, në lidhje me ndryshimet e kërkesave për raportim, të Sistemit të Raportimit të Unifikuar (SRU).

Një tjetër takim teknik u organizua me përgjegjësit e përputhshmërisë së bankave rreth çështjeve lidhur me zbatimin e Rregullores Nr. 60 të BSh-së "Për kërkesat minimale të publikimit të informacionit nga bankat dhe degët e bankave të huaja". Ky takim u organizua në vijim të shqetësimeve të ngritura nga Bankat rreth publikimit të raporteve të gjata financiare dhe tregtare, në përputhje me kërkesat e vendosura nga BSh, dhe u pasua me një letër dërguar BSh-së.

### iv. KËRKESAT PËR INFORMACION NGA AUTORITETI I KONKURENCËS

Gjate gjysmës së dytë të vitit 2009, Autoriteti i Konkurrencës (AK) u kishte dërguar Bankave Anëtare disa kërkesa për informacione, me qëllim verifikimin e përshtatshmërisë së çmimeve për shërbimet bankare, në mbrojtje të konsumatorëve. Në vijim të këtyre kërkesave, kryetari i AAB-së organizoi një takim me Kryetaren e AK-së dhe Drejtorin e Departamentit të Mbikëqyrjes në BSh, që vijoi me dërgimin e një shkrese zyrtare për AK. Në takim dhe në shkresë, Kryetari siguroi palët e interesuara, që komisionet dhe kostot e aplikuara nga Bankat vendosen nga tregu dhe rrjedhimisht janë korrekte, dhe i sugjeroi AK-së mundësinë e përdorimit për nevojat e veta, të të dhënave standarde, si statistikat që përmban Sistemi i Raportimit të Unifikuar (SRU).

### v. PAJISJET FISKALE NË AMBIENTET E BANKAVE

Gjatë muajit Gusht 2009, Drejtoria Rajonale e Tatimeve në Tiranë ushtroi kontrolle në disa nga Bankat Anëtare me qëllim sigurimin e instalimit të pajisjeve fiskale në ambientet e Bankave. Pati edhe raste të vendosjes së gjobave administrative nga Inspektorët e Tatimeve, si pasojë e mungesës së këtyre pajisjeve. AAB iu drejtua me një letër zyrtare, ku shprehte shqetësimet e Bankave, institucionit të sipërpërmendur, Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, dhe Ministrisë së Financave. Kjo nismë rezultoi e suksesshme, pasi përgjigja e marrë nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve theksonte se Bankat nuk përfshihen ndër institucionet për të cilat është i detyrueshëm instalimi i pajisjeve fiskale elektronike.

## vi. RAPORTIMI ONLINE PËR DPPPP-NË

Përgjegjësit e përputhshmërisë së shumë prej Bankave Anëtare ngritën shqetësimin në lidhje me raportimin online të transaksioneve, në Drejtorinë e Përgjithshme për Parandalimin dhe Pastrimin e Parave, që kishte si afati të fundit datën 30 Nëntor 2009.

Sekretariati i AAB-së mblodhi informacion nga të gjitha Bankat në lidhje me gjendjen dhe problemet e ndeshura gjatë implementimit të raportimit online. Duke marrë në konsideratë që disa nga Bankat nuk ishin gati për të proceduar me metodat e reja të raportimit, si pasojë e disa vështirësive praktike, AAB iu drejtua DPPPP-së me një letër zyrtare, ku kërkonte shtyrjen me 4 muaj të afatit të vendosur. Si rezultat, afati i fundit u shty me 1 muaj, deri në 31 Dhjetor 2009.

## vii. KORRESPONDENCA ME INSTITUCIONET PUBLIKE

- Nisur nga shqetësimi i bankave për mbylljen e përkohshme të Zyrës së Regjistrimit të Barrave Sigurorese, dhe vështirësitë praktike që u ndeshën prej kësaj mbylljeje, Sekretariati i AAB-së iu drejtua Ministrisë së Ekonomisë duke i kërkuar shërbim të pandërprerë nga zyra e sipërpërmendur. Në përgjigje, Zv. Ministri në Ministrinë e Ekonomisë informoi AAB-në mbi disa vështirësi organizative, të cilat u tejkaluan, dhe Zyra e Regjistrimit të Barrave Sigurorese tashmë do të ofronte shërbim të pandërprerë për të gjitha palët e interesuara.

- Sekretariati i AAB-së i dërgoi një letër zyrtare Bankës së Shqipërisë, në lidhje me çështjen e informimit në kohë të klientëve për futjen në përdorim të IBAN-it, ku shprehte angazhimin e Bankave për krijimin e të gjithë lehtësive për përdorimin e tij nga klientët, por gjithashtu, edhe shqetësimin lidhur me përfundimin e plotë të të gjithë procesit, duke pasur parasysh mungesën e një sistemi të saktë e të plotë adresash për të gjithë klientët.

- AAB dërgoi shkresa zyrtare për ALBAPOST-ën dhe Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Patundshme (ZRPP), në lidhje me mungesën e pullave juridike për shërbimet zyrtare, (si pullat noteriale që shoqërojnë aktet e dokumentet dhe procedurat e ndryshme ligjore), duke shprehur edhe shqetësimin rreth vonësive të ndryshme të shërbimeve postare, lidhur me përgjigjet e dërguara nga ZRPP për kontratat e kredive hipotekare.

## viii. AKTIVITETI I SPI ALBANIA

SPI Albania, gjatë vitit 2009, koordinoi dhe drejtoi 34 mbledhje të grupeve të punës së projekteve, duke mbledhur kështu rreth 90 profesionistë nga rreth 45 institucione të ndryshme, me pothuaj 120 komunikime me shkrim të rezultateve të veçanta analitike të këtyre grupeve të punës.

Projektet e ndërmarra nga SPI Albania, në interes të të gjitha Bankave Anëtare, gjatë vitit 2009, kanë qenë si më poshtë:

- Përmirësimi i administrimit të rrezikut të likuiditetit, nëpërmjet hartimit të një rregulloreje të re për Administrimin e Rrezikut të Likuiditetit në Banka, në bashkëpunim të ngushtë me Departamentin e Mbikëqyrjes në Bankën e Shqipërisë dhe pjesëtarët e grupit të punës së projektit, përfaqësues të të gjitha Bankave Anëtare.

- Projekti mbi Edukimin Financiar të Konsumatorëve, nëpërmjet të cilit, grupi i punës finalizoi një paketë rekomandimesh që përmban të gjitha masat që mund të merren nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, si edhe institucione të tjera.

- Projekti për rishikimin e kuadrit ligjor të Bankës së Shqipërisë mbi administrimin e pozicioneve të hapura në valutë të bankave.

- Projekti për rishikimin e kuadrit ligjor mbi ekzekutimin e shumave në llogaritë bankare, që kishte për qëllim rishikimin dhe përmirësimin e kuadrit ekzistues rregullator në lidhje me ekzekutimin e titujve ekzekutivë ndaj institucioneve buxhetorë.

- Projekt për vlerësimin e fizibilitetit të krijimit të një Depozitari Qendror, objekti i të cilit ishte të vlerësonte mundësinë e ofrimit në vend të shërbimeve të një depozitari qendror të letrave me vlerë.

### III. AKTIVITETI I KOMITETEVE TË AAB-SË



#### i. KOMITETI I AAB-SË PËR SIGURINË BANKARE

Komiteti i AAB-së për Sigurinë Bankare u mbledh pesë herë gjatë vitit 2009. Në fillim të vitit, Komiteti aprovoi Rregulloren për funksionimin e tij dhe planin e punës për vitin 2009, si dhe zgjodhi Kryetarin dhe Zv/Kryetarët.

Gjatë vitit, anëtarët e Komitetit të AAB-së për Sigurinë Bankare kanë shkëmbyer vazhdimisht informacione mbi ngjarje dhe eksperiencë në lidhje me çështjet e sigurisë në bankat përkatëse.

Dy mbledhjet e Komitetit gjatë fundvitit 2009 kishin si subjekt kryesor problemet që bankat anëtare po ndeshnin gjatë zbatimit të kërkesave të Rregullores Nr. 91 të Bankës së Shqipërisë “Për kushtet minimale teknike dhe të sigurisë të mjediseve në të cilat kryhen veprimtaritë bankare dhe financiare”, dhe çështjet më shqetësuese lidhur me të.

#### ii. KOMITETI JURIDIK I AAB-SË

Komiteti Juridik i AAB-së organizoi disa mbledhje gjatë vitit, kryesisht për të diskutuar rregulloret e Bankës së Shqipërisë. Gjatë fillimit të vitit 2009, Komiteti Juridik diskutoi hartimin e rregullores së BSh-së “Për licencimin e aktivitetit bankar”. Disa nga propozimet dhe vërejtjet më të rëndësishme, të bëra nga anëtarët e Komitetit Juridik, u përfshinë në versionin përfundimtar të kësaj rregulloreje. Gjithashtu, në vijim, Komiteti Juridik diskutoi dhe dha sugjerime edhe mbi projekt-rregulloren “Për administratorët e Bankave”.

AAB organizoi një mbledhje të Anëtarëve të Komitetit Juridik me përfaqësues të BSh-së për të diskutuar rreth dy projekt-rregulloreve të propozuara: “Për Administrimin e Rrezikut të Likuiditetit” dhe “Për veprimtarinë valutore”. Mbledhja u fokusua në disa çështje kryesore dhe mbi vërejtjet që anëtarët e bankave patën ndaj këtyre rregulloreve.

Gjatë fundit të vitit 2009, Komiteti Juridik i AAB-së u mbledh për të diskutuar mbi propozimin e AAB-së për ndryshime në Ligjin “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”.

#### iii. KOMITETI I LUFTËS KUNDËR MASHTRIMIT ME KARTAT

Anëtarët e Komitetit të Luftës Kundër Mashtimit me Kartat kanë qenë vazhdimisht të informuar nga Kryetarja e Komitetit mbi iniciativat e Bashkimit Evropian në lidhje me sigurinë e kartave dhe tendencat më të fundit të mashtimit me to.

#### iv. KOMITETI I SISTEMIT TË PAGESAVE

Pas aprovimit nga Komiteti Ekzekutiv i AAB-së, Komiteti i Sistemit të Pagesave filloi veprimtarinë e tij si një komitet teknik i përhershëm, në Shkurt 2009. Të gjitha bankat përfaqësohen me nga një anëtar në këtë Komitet. Gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2009, anëtarët e Komitetit diskutuan rreth aktivizimit të IBAN për pagesat ndërkombëtare.

## IV. PJESËMARRJE DHE EVENTE TË AAB-SË



### i. KONFERENCA DHE TAKIME

- **Konferenca: “SPI Albania – Një vit nga krijimi”**

AAB dhe SPI Albania organizuan në Janar 2009 konferencën: “SPI Albania – Një vit nga krijimi”, 8 muaj pas fillimit të aktivitetit të Sekretariatit të SPI Albania. Objektivi i konferencës ishte prezantimi i arritjeve të SPI Albania dhe ndikimi i tyre në sektorin bankar, si dhe informimi i komunitetit financiar mbi projektet në proces dhe ato të planifikuara për vitin 2009. AAB vazhdoi të përkrahte dhe të bashkëpunonte me Sekretariatit e SPI-së përgjatë gjithë vitit.

- **Takim i përfaqësuesve të Bankës së Shqipërisë me përfaqësues të bankave anëtare mbi zhvillimet e sistemit bankar**

Banka e Shqipërisë organizoi një takim, në Gusht 2009, mbi zhvillimet në sistemin bankar dhe mundësinë e rritjes së rreziqeve potencialë në të ardhmen. Çështjet kryesore që u diskutuan në këtë takim ishin zhvillimet më të fundit në depozitat dhe portofolet e kredive të bankave; pikëpamje të përgjithshme mbi rreziqet që kërcënojnë stabilitetin financiar; zhvillimet më të fundit në ekonominë vendase dhe prezantimi i përfundimeve të analizave të Bankës së Shqipërisë, të kryera mbi skenarë të ndryshëm; si dhe shqetësimi lidhur me fushatat e marketingut, të ndërmarra nga bankat.

- **Takim i përfaqësuesve të BSh-së me Drejtorë dhe Përgjegjës të Thesarit të bankave**

Ky takim u organizua dhe u mbajt në zyrat e AAB-së, në Shtator 2009, me kërkesë të Bankës së Shqipërisë, dhe me qëllim zhvillimin e diskutimeve rreth luhatjeve të kursit të këmbimit të Euro-s me Lek-un, si dhe mbi rreziqet që mund të lidhen me to. Ky takim pati rezultate pozitive.

- **Takim me Shoqatën e Ndërtuesve dhe Konstruktoreve Shqiptar**

AAB pati një takim me përfaqësues të Shoqatës së Ndërtuesve Shqiptarë, për të qenë më afër të gjithë pjesëtarëve në tregun ekonomik, si edhe për të diskutuar rreth çështjeve aktuale me interes të përbashkët. Pjesëmarrësit në këtë takim theksuan edhe një herë rëndësinë dhe nevojën për një platformë të përbashkët veprimesh mes industrisë së ndërtimit dhe bankave.

- **Tryezë e rrumbullaket për IFRS-të**

Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit (KKK), në bashkëpunim me Sekretariatit e AAB-së, zhvilloi një takim me përfaqësues të bankave, për të diskutuar çështje të ndryshme në lidhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar dhe zbatimin e tyre. Takimi u mbajt në zyrat e AAB-së, në Nëntor 2009.

## ii. EVENTE SOCIALE

### • Pritje Përshëndetjeje

Gjatë vitit 2009, Drejtorët e tre bankave anëtare u larguan nga pozicionet e tyre në bankat përkatëse dhe AAB organizoi disa koktejle lamtumire për këto raste:

Z. Lorenzo RONCARI, Drejtor Ekzekutiv në Intesa Sanpolo Bank – Shqipëri, i cili i dedikoi më shumë se 10 vjet krijimit dhe konsolidimit të Bankës Amerikane në Shqipëri, tashmë Intesa Sanpaolo Bank, u largua nga pozicioni i tij në fillim të Janarit 2009.

Z. Abdul Waheed ALAVI, Drejtor Ekzekutiv në Bankën e Bashkuar të Shqipërisë, anëtar i Komitetit Ekzekutiv të AAB-së, pas mbarimit të kontratës së tij me Bankën e Bashkuar të Shqipërisë, u largua nga detyra dhe nga Shqipëria, në Qershor 2009.

Z. Henry MAUS DE ROLLEY, u largua nga pozicioni si Drejtor i Përgjithshëm i Bankës Popullore - Soci t  G n rale Group dhe nga Shqip ria, n  fund t  Tetorit 2009.

### • P rvjetori i 10<sup>t </sup> i AAB-s 



N  16 Dhjetor 2009, AAB organizoi nj  event t  veqant  p r festimin e 10 vjetorit t  themelimit t  saj, me rastin e festimeve n  fund t  vitit. N  k t  event mori pjes  Guvernatori i Bank s s  Shqip ris , t  gjith  Drejtor t e bankave an tare dhe t  tjer  t  ftuar nderi nga BSh.

Me k t  rast, AAB organizoi edhe nj  iniciativ  bamir sie ku secila Bank  An tare e AAB-s  dhuroi nj  shum  simbolike parash p r nj  organizat  f mij sh t  zgjedhur rastesisht, konkretisht Shoqata Komb tare Edukimi p r Jet n (SHKEJ), misioni i t  cil s  sht  t  kujdeset, mbrojt  dhe promovoj  f mij t n  rrezik.

### iii. PJESËMARRJE

#### • Mbështetja për projektligjin mbi Gjykatat Administrative

Bashkë me përfaqësues të tjerë nga dhomat e tregtisë dhe industrisë në të gjithë vendin, si edhe shoqata të tjera biznesi, AAB mori pjesë vazhdimisht në takime dhe seminare që u organizuan gjatë vitit 2009, në mbështetje të projektligjit mbi Gjykatat Administrative.

#### • Forum i 3të i Hapur për Sistemin Bankar Shqiptar

Kryetari i AAB-së dhe Sekretarja e Përgjithshme, së bashku me shumicën e Drejtorëve të bankave anëtare, morën pjesë në Forumin e Tretë të Hapur të Sistemit Bankar Shqiptar, të organizuar nga Banka e Shqipërisë, në Tetor 2009.

#### • Konferenca e Dytë Ndërkombëtare mbi Investimet e Huaja në Shqipëri

AAB, e përfaqësuar nga Kryetari i saj, mori pjesë në Konferencën e Dytë Ndërkombëtare mbi Investimet e Huaja në Shqipëri, të organizuar nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, në bashkëpunim me Albinvest, dhe nën patronazhin e Kryeministrit të Shqipërisë. Në këtë konferencë, Z. Catalano dha një prezantim mbi Politikën e Kreditimit në Shqipëri.

#### • Takimi i 29të i Anëtarëve të Asociuar të EBF-së në Bruksel

AAB, e përfaqësuar nga Sekretarja e Përgjithshme, mori pjesë në takimin e 29të të Anëtarëve të Asociuar të EBF-së, që u mbajt në Bruksel, në 3 Dhjetor 2009. Znj. Xhaferaj dha një prezantim të zhvillimeve më të fundit ekonomike e financiare në Shqipëri.

#### • Këshilli Konsultativ i Biznesit

AAB mori pjesë vazhdimisht gjatë vitit 2009, duke u përfaqësuar nga Sekretari i Përgjithshëm si një anëtar me të drejta të plota, në të gjitha mbledhjet e Këshillit Konsultativ të Biznesit, në Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

#### • Agjencia e Zhvillimit të Zonave Malore

AAB, gjithashtu, vazhdoi të merrte pjesë, duke u përfaqësuar nga Sekretari i Përgjithshëm si anëtar i Bordit Drejtues të Agjencisë së Zhvillimit të Zonave Malore, në të gjitha mbledhjet e këtij Bordi gjatë vitit 2009.

#### • Mbledhjet e Komitetit të SPI-së

AAB mori pjesë në mënyrë të vazhdueshme në mbledhjet e Komitetit të SPI-së, nëpërmjet Kryetarit të AAB-së, i cili drejtoi disa nga mbledhjet, dhe Sekretarit të Përgjithshëm. Në këto mbledhje u diskutuan e u miratuan propozimet e grupeve të punës dhe rekomandimet e tyre, të cilat u përcollën për tek autoritetet përkatëse për zbatim.

## V. PROMOVIMI DHE MARKETINGU



### i. PUBLIKIMET E AAB-SË

Sekretariati i AAB-së përgatiti Raportin Vjetor 2008 të AAB-së (një botim dy gjuhësh) që u publikua dhe u shpërnda brenda Shtatorit 2009. Raporti përmbante edhe të dhëna mbi aktivitetin financiar të AAB-së për vitin 2008, të audituara nga Banka Kombëtare Tregtare dhe të dorëzuara sipas rregullave përkatëse në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve. Versionet anglisht dhe shqip të raportit janë të aksesueshme në faqen e internetit të AAB-së.

Sekretariati i AAB-së vazhdoi të publikonte Buletinin Tremujor të AAB-së, për tremujorin e fundit të vitit 2008, dhe tremujorin e parë të vitit 2009, dhe do të vazhdojë publikimin e rregullt tremujor të buletineve.

Sekretariati i AAB-së ka mbajtur gjithashtu të përditësuar informacionin në faqen e internetit, duke publikuar të dhënat kryesore tremujore të mbledhura nga bankat anëtare, si edhe të dhëna mujore për sistemin, të marra nga Banka e Shqipërisë.

### ii. MARRËVESHJA IFC – AAB MBI INFORMACIONIN PËR KREDITË HIPOTEKARE

Në vijim të marrëdhënieve e diskutimeve midis Sekretariatit të AAB-së dhe Zyrës së IFC-së në Shqipëri, në lidhje me Projektin e IFC-së “Financimi për Strehim”, palët hynë në një kontratë bashkëpunimi për zhvillimin e një materiali informativ për t’u vendosur në internet, lidhur me kreditë hipotekare, si pjesë e projektit të sipërpërmendur. Materiali përmban informacione të përgjithshme për kreditë hipotekare, dokumentacionin, si dhe aplikacione teknike të thjeshta për përlogaritjen e pagesave të huas, vetëm për qëllime informative.

Në zbatim të kontratës së bashkëpunimit, Sekretariati i AAB-së zhvilloi një material të thjeshtë i cili tashmë është vendosur e mund të aksesohet në faqen e internetit të AAB-së. Gjithashtu, të gjitha bankat u informuan mbi të, dhe u ftuan të vendosin lidhjen me paketën informative në faqet e tyre të internetit.

Në mënyrë përmbledhëse, mund të thuhet pa dyshim se gjatë vitit 2009, një vit veçanërisht kompleks për Sektorin Financiar, aktiviteti i AAB-së ishte në kohezion të plotë me të gjithë Anëtarët e saj, dhe në bashkëpunim të ngushtë me Bankën Qendrore, duke arritur kështu rezultate të rëndësishme në interesin më të mirë të sistemit bankar.





Kanali i Vivarit në parkun Arkeologjik të Butrintit



## VI. AKTIVITETI FINANCIAR I AAB-SË

PASQYRAT FINANCIARE TË AAB-SË PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2009  
AUDITUAR NGA BANKA POPULLORE

### PËRMBAJTJA:

PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR.....	26
PASQYRA E TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE .....	27
PASQYRA E RRJEDHJES SË PARASË .....	28
SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE .....	29

## PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR

Më 31 Dhjetor 2009

Në Lekë

	Shënime	31 Dhjetor 2009	31 Dhjetor 2008
<b>AKTIVET</b>			
Arka dhe Banka	4	4,233,936	2,169,318
<b>Totali i Aktiveve Afatshkurtra</b>		<b>4,233,936</b>	<b>2,169,318</b>
Aktivet Afatgjata			
Aktivet e qëndrueshme, neto	5	1,229,147	1,447,377
<b>Totali i aktiveve Afatgjata</b>		<b>1,229,147</b>	<b>1,447,377</b>
<b>TOTALI I AKTIVEVE</b>		<b>5,463,083</b>	<b>3,616,695</b>
<b>Detyrime</b>		<b>5,463,083</b>	<b>3,616,695</b>
<b>TOTALI I DETYRIMEVE</b>		<b>5,463,083</b>	<b>3,616,695</b>

Pasqyra e pozicionit financiar duhet të lexohet së bashku me shënimet përkatëse 4 deri në 11, si pjesë e pasqyrave financiare.

## PASQYRA E TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE

Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2009  
Në Lekë

	Shënime	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2009	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2008
<b>Të ardhurat</b>			
Kuotat e Anëtarësisë	6	16,000,000	16,000,000
Interesat Bankare		-	-
Të ardhura të tjera	7	-	2,347,395
<b>Totali i të Ardhurave</b>		<b>16,000,000</b>	<b>18,347,395</b>
<b>Shpenzimet</b>			
Amortizimi i Akumuluar	8	(358,347)	(383,030)
Shpenzimet e Përgjithshme dhe të Administrimit	9	(13,745,465)	(19,576,429)
Humbje nga nxjerrja jashtë përdorimit e aktiveve të qëndrueshme	10	(51,364)	-
Diferenca nga kursi i këmbimit fitim ose / (humbje)	11	1,565	(49,870)
<b>Totali i Shpenzimeve</b>		<b>(14,153,612)</b>	<b>(20,009,329)</b>
<b>Teprica / (Defiçiti) i të Ardhurave ndaj Shpenzimeve</b>			
		<b>1,846,388</b>	<b>(1,661,934)</b>
<b>Aktivët Neto në fillim të vitit</b>		<b>3,616,695</b>	<b>5,278,629</b>
<b>Aktivët Neto në fund të vitit</b>		<b>5,463,083</b>	<b>3,616,695</b>

Pasqyra e të Ardhurave dhe Shpenzimeve duhet të lexohet së bashku me shënimet përkatëse 4 deri në II, si pjesë e pasqyrave financiare.


## PASQYRA E RRJEDHJES SË PARASË


Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2009  
Në Lekë

	Shënime	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2009	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2008
<i>Rrjedha e Parasë nga Aktivitete Operacionale:</i>			
Fondet		16,000,000	18,347,395
Rregullime për:			
Amortizimi	5	358,347	383,030
<b>Teprica e Parave nga Aktivitetet Operacionale</b>		<b>16,358,347</b>	<b>18,730,425</b>
<i>Rrjedha e Parasë nga Aktivitete Investuese:</i>			
Blerje të Aktiveve të Qëndrueshme	5	549,828	530,384
<b>Rrjedha e Parasë nga Aktivitetet Investuese</b>		<b>13,743,901</b>	<b>19,626,299</b>
<b>RRITJA NETO NË RRJEDHËN E PARAVE</b>		<b>2,064,618</b>	<b>(1,426,258)</b>
<b>Arka dhe Banka në Fillim të Vitit</b>	4	<b>2,169,318</b>	<b>3,595,576</b>
<b>Arka dhe Banka në Fund të Vitit</b>	4	<b>4,233,936</b>	<b>2,169,318</b>

Pasqyra e rrjedhës së Parave duhet të lexohet së bashku me shënimet përkatëse 4 deri në 11, si pjesë e pasqyrave financiare.

Pasqyrat Financiare të Shoqatës Shqiptare të Bankave (AAB) janë përpiluar dhe nxjerrë në datë 31.03.2009 dhe nënshkruar në emër të AAB-së nga:

Endrita Xhaferaj  
  
 Sekretare e Përgjithshme  
 SHOQATA SHQIPTARE E BANKAVE

Albana Hallvaxhiu  
  
 Zv. Drejtore, Departamenti i Financës  
 BANKA POPULLORE

# SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE

Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2009

## I. Informacion i Përgjithshëm

Shoqata Shqiptare e Bankave (AAB) është themeluar më 15 Prill 1999 me seli në adresën: Blvd. "Dëshmorët e Kombit", Kullat Binjake, Kulla I, Kati 6 A.3, Tiranë, Shqipëri.

AAB është një shoqatë jo fitimprurëse, e cila përpiqet të promovojë standardet më të fundit Bankare të anëtarëve të saj, zhvillimin, stabilitetin dhe efektshmërinë e sistemit bankar shqiptar në përgjithësi, duke kontribuar kështu në përparimin e ekonomisë shqiptare. AAB përbëhet nga 16 anëtarë, mbi baza vullnetare: Alpha Bank – Dega në Shqipëri, Banka Kombëtare Tregtare, Banka Popullore, Banka Credins, Banka e Kreditit të Shqipërisë, Banka Emporiki–Shqipëri, Banka e Parë e Investimeve, Banka Ndërkombëtare Tregtare, Banka Intesa SanPaolo – Shqipëri, Banka Kombëtare e Greqisë – Dega në Shqipëri, Banka ProCredit, Raiffesien Bank - Albania, Banka e Tiranës, Banka Union, Banka e Bashkuar e Shqipërisë, Veneto Banka.

## 2. Baza e Përgatitjes

Librat dhe regjistrimet kontabël të AAB mbahen sipas një modeli të modifikuar të kontabilitetit me bazë *cash-i*. Konkretisht, të ardhurat njihen si të tilla pasi arkëtohen dhe jo kur konstatohen dhe shpenzimet njihen kur paguhen dhe jo kur kryhen, me përjashtim të veprimeve lidhur me pajisjet dhe tokat e ndërtesat, të cilat kapitalizohen dhe amortizohen gjatë gjithë periudhës së pritshme të përdorimit.

Pasqyrat Financiare për vitin 2009 u audituan nga Banka Popullore sipas rotacionit të parashikuar në Statutin e AAB-së.

## 3. Përmbledhje e Politikave Kontabël

### 3.1 Njohja e të Ardhurave dhe Shpenzimeve

Të ardhurat regjistrohen kur arkëtohen dhe shpenzimet kur paguhen.

### 3.2 Aktivet e Qëndrueshme

Aktivët e qëndrueshme mbahen me kosto, minus amortizimin e akumuluar. Amortizimi kryhet sipas metodës lineare, duke shpërndarë koston e pasurisë dhe pajisjeve, përgjatë gjithë periudhës së pritshme të përdorimit të tyre. Amortizimi fillon të regjistrohet që nga muaji pasardhës i atij të blerjes, me normat e mëposhtme:

	Në %
Mobilie	20
Pajisje elektronike	25

### 3.3 Konvertimi nga Monedha e Huaj

AAB përdor si monedhë bazë Lek-un Shqiptar. Të gjithë kontributet dhe pjesa dërrmuese e shpenzimeve janë në Lek. Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në Lek me një kurs që i përfaqësohet atij të datës së kryerjes së transaksionit. Aktivët dhe pasivët janë konvertuar në Lek, duke përdorur kursin e këmbimit të Bankës së Shqipërisë. Diferencat nga kursi i këmbimit janë regjistruar në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

### 3.4 Tatimet dhe taksat

AAB është një shoqëri jo fitimprurëse dhe si e tillë është e përjashtuar nga tatimi mbi fitimin në Shqipëri. AAB është subjekt i tatimit në burim, i tatimit mbi të ardhurat financiare dhe i kontributeve të sigurimeve shoqërore.

## 4. Arka dhe Banka

Arka dhe banka përbëhen nga sa më poshtë:

Në Lekë	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2009	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2008
Arka	21,706	67,649
Banka	4,212,230	2,101,669
<b>Total</b>	<b>4,233,936</b>	<b>2,169,318</b>

Llogaritë në banka paraqiten si më poshtë:

	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2009	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2008
Llogari Rrjedhëse		
Në Lekë	4,212,230	2,101,669
Në USD	-	-
Në EUR	-	-
<b>Total</b>	<b>4,212,230</b>	<b>2,101,669</b>

## 5. Aktivët e Qëndrueshme

Aktivët e Qëndrueshme përbëhen nga sa më poshtë:

Në Lekë	Mobilie	Pajisje Elektronike	Total
<b>Kosto</b>			
Në 31 Dhjetor 2008	1,555,475	1,008,097	<b>2,563,572</b>
Shtesat gjatë vitit 2009	-	191,481	191,481
Pakësimet gjatë vitit 2009	-	(206,902)	(206,902)
Në 31 Dhjetor 2009	1,555,475	992,676	<b>2,548,151</b>
<b>Amortizimi i Akumuluar</b>			
Në 31 Dhjetor 2008	607,913	508,282	<b>1,116,195</b>
Amortizimi gjatë vitit 2009	189,512	168,835	358,347
Pakësimet gjatë vitit 2009	-	(155,538)	(155,538)
Në 31 Dhjetor 2009	797,425	521,579	<b>1,319,004</b>
<b>Vlera Neto e Librit</b>			
Në 31 Dhjetor 2008	<b>947,562</b>	<b>499,815</b>	<b>1,447,377</b>
Në 31 Dhjetor 2009	<b>758,050</b>	<b>471,097</b>	<b>1,229,147</b>

## 6. Kuotat e Anëtarësimit

Të ardhurat e arkëtuara gjatë vitit 2009 dhe 2008 janë si vijon:

Në Lekë	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2009	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2008
Kuotat e anëtarësimit në LEK	16,000,000	16,000,000
Kuotat e anëtarësimit në monedhë të huaj	-	-
<b>Total</b>	<b>16,000,000</b>	<b>16,000,000</b>

## 7. Të Ardhura të Tjera

Në vitin 2009 AAB nuk ka përfituar të ardhura të tjera përveç atyre nga kuotat vjetore të anëtarësimit, siç tregohet më poshtë:

Në Lekë	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2009	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2008
Fonde nga trajnimet	-	2,347,395
Kuotat e pranimit	-	-
<b>Total</b>	<b>-</b>	<b>2,347,395</b>

## 8. Amortizimi

Në Lekë	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2009	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2008
Amortizimi i akumuluar për pajisjet elektronike	168,835	146,139
Amortizimi i akumuluar për pajisjet e zyrës	189,512	236,890
<b>Amortizimi total për vitin</b>	<b>358,347</b>	<b>383,030</b>

## 9. Management and general expenses

Shpenzimet e përgjithshme dhe të administrimit në 2009 dhe 2008 përbëhen nga sa vijon:

Në Lekë	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2009	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2008
Pagat	3,448,646	4,071,633
Sigurime Shoqërore & Tatime mbi të Ardhurat	1,241,841	1,167,187
Shpenzime të tjera për personelin	529,279	304,087
Shpenzime Anëtarësie	543,000	402,150
Shpenzime për Udhëtime Pune	439,957	673,326
Shpenzime Organizative	1,265,311	4,741,707
Shpenzime për Reklama & Internet	1,094,617	3,137,234
Taksa Vendore	36,829	56,498
Mjete Zyre dhe Shërbime Utilitare	4,640,025	4,524,645
Shpenzime të Tjera	482,930	463,429
Shpenzime për Komisione Bankare	23,030	34,533
<b>Total</b>	<b>13,745,465</b>	<b>19,576,429</b>

## 10. Humbje nga nxjerrja jashtë përdorimit e pajisjeve elektronike

Në fund të vitit 2009 u nxorën nga përdorimi pajisjet elektronike si më poshtë:

Data e Blerjes	Vlera e Blerjes	Amortizimi i Akumuluar (Lekë)	Vlera Neto e Librit (Lekë, 31.12.2009)
4/29/2004	88,822	71,257	17,565
4/29/2004	19,012	15,253	3,760
11/7/2004	99,067	69,028	30,039
<b>Humbje totale nga nxjerrja jashtë përdorimit</b>			<b>51,364</b>

## 11. Diferenca nga Kursi i Këmbimit

	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2009	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2008
Fitim / (humbje) nga Kursi i Këmbimit	1,565	(49,780)





# PROFILI I BANKAVE ANËTARE

## SHPËRNDARJA GJEOGRAFIKE E RRJETIT BANKAR SHQIPTAR

Në fund të vitit 2009

Nr	Rrethet / Bashkitë & Komunat	Alpha Bank	Banka Kombëtare Tregtare	Banka Popullore	Credins Bank	Credit Bank of Albania	Emporiki Bank	First Investment Bank	International Commercial Bank
1	<b>Berat</b>	✓	✓	✓				✓	
	Ura Vajgurore	✓							
2	<b>Bulqizë</b>	✓							
3	<b>Delvinë</b>	✓	✓	✓					
4	<b>Devoll</b>						✓		
	Bilisht	✓	✓	✓					
	Kapshticë		✓						
5	<b>Dibër</b>	✓	✓	✓					
	Peshkopi	✓	✓	✓					
6	<b>Durrës</b>	✓	✓	✓	✓		✓	✓	
	Shijak				✓				
7	<b>Elbasan</b>	✓	✓	✓	✓		✓	✓	
	Belsh	✓							
	Cërik	✓							
8	<b>Fier</b>	✓	✓	✓	✓		✓	✓	✓
	Patos	✓							
	Roskovec			✓					
9	<b>Gjirokastrë</b>	✓	✓	✓			✓		
	Kakavijë	✓	✓				✓		
10	<b>Gramsh</b>			✓					
11	<b>Has</b>								
	Krumë								
12	<b>Kavajë</b>	✓	✓	✓	✓		✓		
	Progozhinë		✓	✓					
	Shkozë		✓		✓				
13	<b>Kolonjë</b>	✓		✓					
	Ersekë	✓		✓					
14	<b>Korçë</b>	✓	✓	✓	✓		✓	✓	
	Maliq								
15	<b>Krujë</b>	✓	✓	✓					
	Fushë Krujë	✓	✓	✓	✓				
16	<b>Kuçovë</b>	✓	✓	✓					
17	<b>Kukës</b>	✓	✓	✓	✓				
18	<b>Kurbin</b>								
	Laç	✓	✓	✓					
	Mamurras								
19	<b>Lezhë</b>	✓	✓	✓	✓		✓		
	Shëngjin			✓			✓		
20	<b>Librazhd</b>	✓	✓	✓					
	Prrënjës								
21	<b>Lushnjë</b>	✓	✓	✓	✓		✓		
	Divjakë			✓					
22	<b>Malësi e Madhe</b>	✓	✓	✓					
	Koplik	✓	✓	✓					
	Bushat		✓						
23	<b>Mallakastër</b>								
	Ballsh	✓		✓					
24	<b>Mat</b>	✓		✓					
	Burrë								
25	<b>Mirditë</b>		✓	✓					
	Prërshen		✓	✓					
26	<b>Peqin</b>								
27	<b>Përmet</b>	✓		✓					
	Këlcyrë								
28	<b>Pogradec</b>	✓	✓	✓					
	Qafë - Thanë								
29	<b>Pukë</b>								
	Fushë Arrëz								
30	<b>Sarandë</b>	✓	✓	✓		✓	✓		
	Ksamil								
31	<b>Shkodër</b>	✓	✓	✓	✓		✓	✓	
32	<b>Skrapar</b>	✓							
	Çorovodë								
	Poliçan								
33	<b>Tepelenë</b>	✓		✓					
	Memaliaj								
34	<b>Tiranë</b>	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓
	Dajti	✓	✓	✓	✓				
	Kamëz	✓	✓	✓	✓				
	Kashar	✓	✓	✓	✓				
	Rinas		✓	✓					
	Sauk	✓	✓	✓					
	Vorë		✓		✓				
35	<b>Tropojë</b>								
	Bajram Curri								
36	<b>Vlorë</b>	✓	✓	✓	✓		✓	✓	
	Himarë	✓		✓					
	Orikum		✓						

## SHPËRNDARJA GJEOGRAFIKE E RRJETIT BANKAR SHQIPTAR

Në fund të vitit 2009

No	Districts / Municipalities & Communes	Intesa Sanpaolo Bank	National Bank of Greece	ProCredit Bank	Raiffeisen Bank	Tirana Bank	Union Bank	United Bank of Albania	Veneto Banka
1	<b>Berat</b>		✓	✓	✓	✓	✓		
	Ura Vajgurore				✓				
2	<b>Bulqizë</b>				✓				
3	<b>Delvinë</b>				✓				
4	<b>Devoll</b>								
	Bilisht			✓	✓	✓			
	Kapshiticë				✓	✓			
5	<b>Dibër</b>								
	Peshkopi				✓				
6	<b>Durrës</b>	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓
	Shijak				✓	✓			
7	<b>Elbasan</b>	✓	✓	✓	✓	✓	✓		
	Belsh				✓				
	Cërrik				✓				
8	<b>Fier</b>	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓
	Patos		✓		✓	✓			
	Roskovec				✓				
9	<b>Gjirokastrë</b>	✓	✓	✓	✓	✓			
	Kakavijë				✓	✓			
10	<b>Gramsh</b>				✓				
11	<b>Has</b>				✓				
	Krumë				✓				
12	<b>Kavajë</b>		✓	✓	✓	✓	✓		
	Prrogzhinë				✓		✓		
	Shkozë			✓	✓				
13	<b>Kolonjë</b>								
	Ersekë				✓				
14	<b>Korçë</b>	✓	✓	✓	✓	✓	✓		
	Maliq				✓				
15	<b>Krujë</b>				✓	✓			
	Fushë Krujë		✓		✓	✓	✓		
16	<b>Kuçovë</b>			✓	✓				
17	<b>Kukës</b>		✓	✓	✓		✓		
18	<b>Kurbin</b>				✓	✓	✓		
	Laç			✓	✓	✓	✓		
	Mamurras				✓				
19	<b>Lezhë</b>	✓	✓	✓	✓	✓	✓		
	Shëngjin	✓			✓	✓			
20	<b>Librazhd</b>				✓	✓			
	Prenjas				✓				
21	<b>Lushnjë</b>	✓	✓	✓	✓	✓	✓		
	Divjakë			✓	✓		✓		
22	<b>Malësi e Madhe</b>				✓				
	Koplik				✓				
	Bushat				✓				
23	<b>Mallakastër</b>								
	Ballsh				✓				
24	<b>Mat</b>				✓				
	Burrel				✓				
25	<b>Mirditë</b>								
	Rrëshen				✓				
26	<b>Peçin</b>				✓				
27	<b>Përmet</b>				✓	✓			
	Këlcyrë				✓				
28	<b>Pogradec</b>		✓	✓	✓	✓	✓		
	Qafë - Thanë				✓				
29	<b>Pukë</b>				✓				
	Fushë Arrëz				✓				
30	<b>Sarandë</b>		✓	✓	✓	✓			
	Ksamil				✓	✓			
31	<b>Shkodër</b>	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓
32	<b>Skrapar</b>				✓				
	Çorovodë				✓				
	Poliçan				✓		✓		
33	<b>Tepelenë</b>				✓				
	Memaliaj				✓				
34	<b>Tiranë</b>	✓	✓	✓	✓		✓	✓	✓
	Dajti				✓				
	Kamëz			✓	✓	✓			
	Kashar				✓				
	Rinas	✓			✓				
	Sauk			✓	✓				
	Vorë				✓	✓			
35	<b>Tropojë</b>				✓				
	Bajram Curri				✓	✓			
36	<b>Vlorë</b>	✓	✓	✓	✓	✓	✓		✓
	Himarë				✓				
	Orikum				✓				

## PAMJE E PËRGJITHSHME

Alpha Bank – Shqipëri është degë e Alpha Bank Group e cila është themeluar në vitin 1879 në Kalamatë, nga Z. John.F.Costopoulos dhe është një nga bankat më të mëdha në Greqi. Emri i parë ishte Banka e Kalamata-s, që në vitin 1924 ndryshoi në “Banque de Credit Commercial Hellenique”, në 1947 ndryshoi sërisht në “Commercial Credit Bank”, në vitin 1972 në “Credit Bank” dhe në Mars 1994 në “Alpha Credit Bank”. Në vitin 1999 “Alpha Credit Bank” u bashkua me Bankën Ioniane dhe Popullore, një bankë e zotëruar nga shteti, dhe në Prill të vitit 2000 skema e re u quajt Alpha Bank.

Alpha Bank – Shqipëri që nga fillimi i aktivitetit të saj në Shqipëri në vitin 1998 ka qenë një partner i fuqishëm dhe dinamik në zhvillimin e vendit. Shumë projekte me karakter kombëtar siç janë ndërtimi i seksionit Rrëshen – Kalimash, i rrugës kombëtare Durrës – Morinë dhe ndërtimi i Aeroportit Ndërkombëtar të Tiranës “Nënë Tereza” janë financuar nga Alpha Bank- Shqipëri në bashkëpunim të ngushtë me Qeverinë Shqiptare.

Alpha Bank në Shqipëri operon me 47 degë në të gjithë vendin, dhe gjithashtu ka prezencë në qendra të rëndësishme tregtare të ngritura kohët e fundit.

Me besim, devotshmëri dhe vizion të qartë, Alpha Bank – Shqipëri u përmbahet vlerave që kanë drejtuar aktivitetin e saj që nga themelimi: integriteti, respekti, përkushtimi dhe cilësia, të cilat janë vlera që do të vazhdojnë të mbeten vitale edhe në të ardhmen.

DREJTOR EKZEKUTIV: Z. ANDREAS GALATOULAS

TË DHËNA PËRMBLEDHËSE MË 31.12.2009:

	Milionë Lekë	Mijë EURO		
<b>Mjetet</b>	65,040.8	471,447	<b>Nr. i degëve dhe agjencive</b>	<b>47</b>
<b>Huatë</b>	45,492.9	329,754		
Huatë për Biznese	26,175.0	189,729	<b>Nr. i punonjësve</b>	<b>353</b>
Huatë për Individë	19,317.9	140,025		
<b>Kapitali Aksioner</b>	7,882.6	57,137	<b>Struktura e Aksionerëve:</b>	
<b>Depozitat</b>	51,580.5	373,880		
Depozitat e Bizneseve	9,899.1	71,753	ALPHA BANK, Athinë, GREQI	100%
Depozitat e Individëve	41,681.4	302,127		
<b>Fitimi Neto</b>	894.2	6,481		
Të dhëna të Audituar sipas IFRS; 1 EURO = 137.96 Lekë				



BANKA KOMBËTARE TREGTARE  
THEMELUAR NË SHQIPËRI NË VITIN 1993

## PAMJE E PËRGJITHSHME

Banka Kombëtare Tregtare u themelua në Janar 1993, nga bashkimi i Bankës Tregtare Shqiptare (BTSH) dhe Bankës Kombëtare të Shqipërisë (BKSH). Ajo u krijua si Shoqëri Aksionere në Korrik 1997 me një kapital prej 2.7 miliardë Lekësh dhe përfundoi procesin e privatizimit në vitin 2000.

Në shkurt 2003, me një vendim të Mbledhjes së Përgjithshme të Aksionerëve, kapitali i paguar i bankës arriti në shumën 14,64 milionë dollarë, duke e kthyer BKT-në në bankën më të kapitalizuar të sistemit bankar shqiptar.

Gjatë viteve 2006 – 2009 BKT, me performancën e arritur merr një seri vlerësimesh kombëtare dhe ndërkombëtare, ndër të cilat disa herë me radhë si “Banka më e mirë e vitit” në Shqipëri, Banka më e mirë, ndër bankat e nivelit të mesëm, në Evropën Juglindore” duke kulmuar me vlerësimin si “Banka më e mirë e vitit në Evropën Juglindore në vitin 2009”. Njëkohësisht për dy vite rresht, BKT vlerësohet me notën AAA (Alb) nga instituti prestigjioz JCR-ER duke konstatuar në këtë mënyrë rritjen akoma më të madhe të besueshmërisë dhe qëndrueshmërisë së BKT në sistemin bankar shqiptar.

Pas vendosjes për zgjerim edhe në Kosovë, numri i degëve në Kosovë arrin në 12, duke e bërë BKT-në bankën shqiptare më të madhe në rajon.

Më 30 Qershor 2009, Çalik Financial Services blen pjesën e aksioneve të Korporatës Ndërkombëtare Financiare (IFC) dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim duke u bërë në këtë mënyrë aksionerja e vetme e BKT me 100% të aksioneve.

DREJTOR EKZEKUTIV: Z. SEYHAN PENCAPLIGIL

TË DHËNA PËRMBLEDHËSE MË 31.12.2009:

	Milionë Lekë	Mijë EURO		
<b>Mjetet</b>	128,389.4	930,628	<b>Nr. i degëve dhe agjencive</b>	<b>68</b>
<b>Huatë</b>	47,356.1	343,260		
Huatë për Biznese	33,515.3	242,935	<b>Nr. i punonjësve</b>	<b>854</b>
Huatë për Individë	13,840.8	100,325		
<b>Kapitali Aksioner</b>	9,070.4	65,747	<b>Struktura e Aksionerëve:</b>	
<b>Depozitat</b>	111,824.3	810,556		
Depozitat e Bizneseve	21,241.3	153,967	Çalik Finansal Hizmetler A.S.	100%
Depozitat e Individëve	90,583.0	656,589		
<b>Fitimi Neto</b>	1,229.7	8,913		

Të dhëna të Audituar sipas IFRS; 1 EURO = 137.96 Lekë

## PAMJE E PËRGJITHSHME

Banka Popullore është një nga institucionet bankare më të reja dhe më dinamike që vepron në tregun shqiptar. Banka pati zanafillën e saj nga nisma e sipërmarrësve shqiptarë më me influencë dhe hapi dyert e saj për biznesin dhe klientët në Mars 2004. Një moment historik për bankën ishte përvetësimi i pjesës më të madhe të aksioneve të saj nga Grupi Société Générale në Korrik 2007. Si rrjedhojë Banka Popullore u bë anëtare e një prej grupeve bankare më të njohur në botë dhe ku tani është duke kontribuar në zbatimin e planit të zgjerimit të Grupit SG në rajon.

Që prej kohës së themelimit, Banka Popullore rriti prezencën e saj duke zgjeruar rrjetin e degëve në të gjithë territorin shqiptar dhe duke ofruar një gamë të gjerë produktesh dhe shërbimesh tek të gjithë kategoritë e klientëve.

Banka Popullore mban lidhje të ngushta dhe aktive me linja të tjera biznesi dhe vartëse të Grupit SG për të identifikuar dhe përmbushur mundësi biznesi dhe sinergji të përbashkëta. Grupi Société Générale dhe Banka Popullore kanë besim të plotë tek Shqipëria, mundësitë që ajo ofron dhe zhvillimin e saj në të ardhmen.

Politika e Bankës Popullore është zgjerimi i gamës së produkteve dhe shërbimeve të saj ndaj qytetarëve, bizneseve dhe grupeve të tjera të klientelës me synimin që të krijojë një pozicion dominues si një bankë universale. Deri më tani, banka ka hapur 41 degë në të gjitha qytetet kryesore të Shqipërisë. Banka Popullore Société Generale ka krijuar tashmë reputacionin si një prej bankave kryesore në Shqipëri duke ofruar profesionalizëm, kualitet në shërbim dhe shpirtin e një skuadre duke inkuorporuar dhe shfaqur standardet e Grupit Société Générale.

DREJTOR EKZEKUTIV: Z. HUBERT DE SAINT JEAN

TË DHËNA PËRMBLEDHËSE MË 31.12.2009:

	Milionë Lekë	Mijë EURO	Nr. i degëve dhe agjencive	41
<b>Mjetet</b>	38,795.7	281,210	<b>Nr. i punonjësve</b>	<b>379</b>
<b>Huatë</b>	18,021.4	130,628	<b>Struktura e Aksionerëve:</b>	
Huatë për Biznese	10,569.4	76,612	Societe Generale	75%
Huatë për Individë	7,452.0	54,016	Z. Vasil Naçi	10%
<b>Kapitali Aksioner</b>	4,340.5	31,462	Z. Kosta Sotiri	5%
<b>Depozitat</b>	31,653.9	229,442	Z. Kristo Naçi	5%
Depozitat e Bizneseve	2,233.7	16,191	Z. Behar Male	2%
Depozitat e Individëve	29,420.2	213,251	Z. Guxim Resuli	1%
<b>Fitimi Neto</b>	(499.7)	(3,622)	Z. Lefter Sota	1%
Të dhëna të Audituar sipas IFRS; 1 EURO = 137.96 Lekë			Z. Vladimir Kosta	1%
			Z. Adrian Doçi	1%



BANKA CREDINS  
THEMELUAR NË SHQIPËRI NË VITIN 2003

## PAMJE E PËRSGJITHSHME

Banka Credins u themelua në Mars 2003 dhe veçohet në historikun e bankingut shqiptar si e para bankë private me 100% kapital shqiptar. Që nga krijimi i saj, përmes rrjetit të degëve dhe agjencive të shtrirë në pothuajse gjithë territorin e Shqipërisë, ofron një gamë të plotë të produkteve dhe shërbimeve bankare të përshtatura me nevojat e grupeve të ndryshme të klientëve, duke përfshirë individë, biznese të vogla dhe SME, korporata, e deri tek Institucionet Publike.

Një zhvillim kulminant në aktivitetin e Bankës Credins ishte konkretizimi i interesimit të investitorëve të huaj, i cili u zyrtarizua në Janar 2008 me firmosjen e marrëveshjes me dy fonde të rëndësishme të huaja, që blenë 25.34% të aksioneve të Bankës Credins. Këto janë: Fondi i Investimeve Financiare në Ballkan (BFSE Holding B.V), Hollandë dhe Sekretariati Shtetëror Zviceran i Marrëdhënieve Ekonomike (SECO).

Banka Credins ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me institucione të rëndësishme financiare ndërkombëtare ku mund të përmenden marrëveshja me American Express, ajo me Visa ku Credins është "Principal Member" si dhe marrëveshjet me EFSE dhe UNOPS për financimin e bizneseve Mikro dhe SME.

Në vitin 2009 Banka Credins vlerësohet sipas Indeksit të Moody's, me E+ për nga renditja e fuqisë financiare të Bankës. Sipas këtij vlerësimi ajo, konsiderohet si një Bankë me bazë të qëndrueshme financiare, likuiditet e përfitueshmëri të mirë dhe efikasitet të lartë. Vlerësimi i një Institucioni Bankar sipas Moody's, mundëson vlerësimin e Bankës Credins në tregjet financiare ndërkombëtare.

DREJTOR EKZEKUTIV: Z. ARTAN SANTO

TË DHËNA PËRMBLEDHËSE MË 31.12.2009:

	Milionë Lekë	Mijë EURO	Nr. i degëve dhe agjencive	33
			Nr. i punonjësve	447
<b>Mjetet</b>	50,136.7	363,415	<b>Struktura e Aksionerëve:</b>	
<b>Huatë</b>	30,242.3	219,211	Aleksandër Pilo	24.9%
Huatë për Biznese	24,314.8	176,246	BFSE Holding	22.2%
Huatë për Individë	5,927.5	42,965	Z. Renis Tërshane	20.8%
<b>Kapitali Aksioner</b>	3,732.1	27,052	Z. Artan Santo	5.0%
<b>Depozitat</b>	43,251.6	313,508	Zj. Monika Milo	5.0%
Depozitat e Bizneseve	11,398.5	82,622	Bushati shpk	4.7%
Depozitat e Individëve	31,853.1	230,886	Z. Maltin Korkuti	4.2%
<b>Fitimi Neto</b>	524.8	3,804	Zj. Arjana Santo	3.3%
			SECO	3.2%
			Z. Sejdin Zere	2.0%
			Z. Kostaq Milo	1.6%
			Z. Asllan Grezda	1.2%
			Z. Leonat Koco	0.8%
			Z. Jorgji Balli	0.8%
			Emigres SL	0.3%

Të dhëna të Audituar sipas IFRS; 1 EURO = 137.96 Lekë

## PAMJE E PËRGJITHSHME

Banka e Kreditit të Shqipërisë sh.a është një kompani aksionere shqiptare me qendër në Tiranë. Aksionerët e saj, vëllezërit Al-Kharafi (Kharafi Group) përfaqësojnë një grup Kuvajtian me pjesëmarrje dhe aktivitete të ndryshme në të gjithë botën. I themeluar si një kompani tregtare më shumë se 100 vjet më parë, ky grup u zhvillua në një kompani shumëkombëshe dhe ka qenë aktiv në Shqipëri që në vitin 1992, duke krijuar këtu kompani të mëdha, të suksesshme e me reputacion shumë të mirë në fushat e investimeve, kontraktimeve, pjesëmarrjes në tenderë infrastrukture, rrugësh, spitalesh, urash, aeroportesh e projektesh të mëdha në Inxhinierinë Civile.

Që kur u licencua nga Banka e Shqipërisë në Gusht 2002, Banka e Kreditit të Shqipërisë ka zhvilluar aktivitetin e saj në tregun bankar duke ofruar një gamë të gjerë produktesh dhe shërbimesh, veçanërisht produkte tregtare, nëpërmjet një rrjeti të gjerë korrespondentësh ndërkombëtarë. Produktet bankare dhe shërbimet financiare që ofrohen nga banka përfshijnë pranimin dhe mbajtjen e depozitave, dhënien e lehtësive kredituese, shërbime pagesash si dhe garanci bankare e të tjera.

Më 31 Dhjetor 2009, Banka operonte me zyrat qendrore në Tiranë dhe dy degët e saj, në Tiranë dhe Sarandë, dhe kishte një staf prej 31 punonjësish, duke përfshirë një menaxher të huaj.

DREJTORE EKZEKUTIVE: ZJ. SHERINE KAMEL

TË DHËNA PËRMBLEDHËSE MË 31.12.2009:

	Milionë Lekë	Mijë EURO		
<b>Mjetet</b>	1,770.2	12,831	<b>Nr. i degëve dhe agjencive</b>	<b>2</b>
<b>Huatë</b>	266.7	1,933		
Huatë për Biznese	266.6	1,932	<b>Nr. i punonjësve</b>	<b>32</b>
Huatë për Individë	0.1	1		
<b>Kapitali Aksioner</b>	1,230.7	8,920	<b>Struktura e Aksionerëve:</b>	
<b>Depozitat</b>	459.6	3,331	1. Jassim M.A Al-Kharafi	33.3%
Depozitat e Bizneseve	410.6	2,976	2. Nasser M.A Al-Kharafi	33.3%
Depozitat e Individëve	49.0	355	3. Fawzi M.A Al-Kharafi	33.3%
<b>Fitimi Neto</b>	26.6	193		
Të dhëna të Audituar sipas IFRS; 1 EURO = 137.96 Lekë				





BANKA EMPORIKI - SHQIPËRI  
THEMELUAR NË SHQIPËRI NË VITIN 1999

## PAMJE E PËRSGJITHSHME

Banka Emporiki – Shqipëri, është degë me 100% kapital të Grupit Emporiki Bank Greqi S. A. Ajo operon në tregun shqiptar që prej vitit 1999 si një bankë universale e cila ka një qëllim: të mbajë marrëdhënie të shkëlqyera me klientët nëpërmjet një stafi profesional dhe të devotshëm.

Që në vitin 2004, Banka Emporiki Shqipëri ka synuar të rrisë të gjitha aktivitetet e *RETAIL* që përfshijnë individët dhe biznesin i vogël ndërkohë që ka zgjeruar prezencën në tregun e biznesit të madh dhe korporatave, fushë në të cilën Banka Emporiki punon prej shumë vitesh duke synuar udhëheqjen e saj.

Orientimi i ri u pasua me zgjerimin nëpërmjet shumimit të degëve në Shqipëri, në mënyrë që të arrihet sa më pranë klientëve e sa më efektiv në plotësimin e nevojave të tyre. Banka Emporiki aktualisht ka shtrirë rrjetin e saj në gjithë vendin duke numëruar 20 degë dhe tre agjenci. Ky zgjerim nisi në vitin 2004 dhe arriti kulmin në vitin 2006 duke mbuluar 90 për qind të territorit shqiptar.

Aktiviteti i Bankës Emporiki ka ardhur duke u fuqizuar sidomos pasi u ajo bë pjesë e Crédit Agricole Group i cili në muajin Gusht të vitit 2006 bleu 72 % të aksioneve të Grupit Emporiki, blerje që u finalizua me 100% të zotërimit të tyre në mars 2010. Gjithashtu lideri financiar francez do të jetë tashmë 100% prezent edhe në vendin tonë nëpërmjet filialit Emporiki Bank Shqipëri.

Misioni i bankës është të zotërojë statusin e një institucioni financiar udhëheqës, duke ofruar shumëllojshmëri produktesh bankare të standardeve të larta për klientët, si dhe duke u angazhuar në zgjerimin e mëtejshëm ekonomik të sektorit privat dhe publik.

DREJTOR EKZEKUTIV: Z. GEORGE CARACOSTAS

TË DHËNA PËRMBLEDHËSE MË 31.12.2009:

	Milionë Lekë	Mijë EURO		
<b>Mjetet</b>	29,994.8	217,417	<b>Nr. i degëve dhe agjencie</b>	<b>23</b>
<b>Huatë</b>	27,304.9	197,919		
Huatë për Biznese	19,346.2	140,230	<b>Nr. i punonjësve</b>	<b>238</b>
Huatë për Individë	7,958.8	57,689		
<b>Kapitali Aksioner</b>	4,075.0	29,537	<b>Struktura e Aksionerëve:</b>	
<b>Depozitat</b>	11,100.4	80,461		
Depozitat e Bizneseve	4,787.1	34,699	Emporiki Bank of Greece	100%
Depozitat e Individëve	6,313.3	45,762		
<b>Fitimi Neto</b>	(218.6)	(1,655)		
Të dhëna të Audituaras sipas IFRS				
Fund periudhe 1 EURO = 137.96 Lekë; Fitimi neto me kurs mesatar 1 EURO = 132.06 Lekë				

## PAMJE E PËRGJITHSHME

Fibank Albania është pjesë e grupit ndërkombëtar bankar FIRST INVESTMENT BANK, SHA, rrjeti i të cilit është i shtrirë në Ballkan.

Fibank është bankë bullgare, me seli në Sofie, Bullgari, e cila u bë prezente në tregun bankar të Republikës së Shqipërisë duke krijuar degën e saj në vitin 1999. Aktiviteti i saj bankar ka ardhur nga viti në vit në rritje, kjo si rrjedhojë e shumëllojshmërisë dhe cilësisë së shërbimeve dhe produkteve, që ofronte, edhe në sajë të një stafi tepër të kualifikuar. Zhvillimet intensive në aspektin ekonomik, politik e bankar në Republikën e Shqipërisë, ishin faktorët bazë që ndikuan në rritjen e prezencës dhe zgjerimin e aktivitetit të Fibank, për tu afirmuar si një institucion me reputacion të lartë në sistemin bankar shqiptar. Kjo solli krijimin e shoqërisë anonime FIRST INVESTMENT BANK, ALBANIA SHA, e cila trashëgoi të gjithë aktivitetin e Degës në Korrik 2007 dhe rritjen e totalit të aktiveve, që deri në fund të vitit 2009 është mbi 150%. Aktualisht, rrjeti i saj mbulon rajonet e mëdha në vend me degë në qytetet kryesore.

Fibank Albania aspirojnë të renditet tek bankat me rritje shumë të shpejtë ndër bankat e vogla në Shqipëri. Duke zbatuar sloganin “Cilësia vjen e para”, Fibank synon të njihet si bankë novatore, duke ofruar produktet dhe shërbimet më të mira në treg, duke siguruar një karrierë të shkëlqyer për punonjësit e saj dhe duke kontribuar për komunitetin.

DREJTOR EKZEKUTIV: Z. BOZHIDAR TODOROV

TË DHËNA PËRMBLEDHËSE MË 31.12.2009:

	Milionë Lekë	Mijë EURO		
<b>Mjetet</b>	5,867.2	42,525	<b>Nr. i degëve dhe agjencive</b>	<b>9</b>
<b>Huatë</b>	1,578.6	11,442		
Huatë për Biznese	597.0	4,327	<b>Nr. i punonjësve</b>	<b>100</b>
Huatë për Individë	1,021.0	7,400		
<b>Kapitali Aksioner</b>	1,304.8	10,474	<b>Struktura e Aksionerëve:</b>	
<b>Depozitat</b>	4,535.5	32,873		
Depozitat e Bizneseve	2,826.0	20,483	First Investment Bank AD Sofia	99.9998%
Depozitat e Individëve	1,709.4	12,390	First Financial Brokerage House Ltd Sofia	0.0001%
<b>Fitimi Neto</b>	35.8	260	Vitosh Ventures AD	0.0001%

Të dhëna të Audituar sipas IFRS; 1 EURO = 137.96 Lekë



Banka Nderkombetare Tregtare  
International Commercial Bank

BANKA NDËRKOMBËTARE TREGTARE  
THEMELUAR NË SHQIPËRI NË VITIN 1996

## PAMJE E PËRGJITHSHME

Banka Ndërkombëtare Tregtare SH.A. është një shoqëri aksionere e themeluar në Shqipëri në Janar 1996 dhe e vendosur në Tiranë. Banka Ndërkombëtare Tregtare filloi veprimtarinë e saj të plotë në vitin 1997, duke ofruar një paketë të plotë shërbimesh, veçanërisht transaksione që lidhen me tregtinë, duke përdorur rrjetin e saj të gjerë të bankave korrespondente ndërkombëtare.

Sot Banka operon si pjesë e Grupit Bankar ICB. ICB Financial Group Holdings AG është një grup që kontrollon banka të ndryshme që operojnë në Afrikë, Azi dhe Evropë. Ky grup, në katërbëdhjetë vitet e fundit ka krijuar ose blerë banka në këto kontinente dhe operon në katërbëdhjetë vende, nëpërmjet bankierëve shumë të aftë e me eksperiencë. Grupi është duke zgjeruar dhe konsoliduar prezencën e tij në vendet pritëse, aty ku shërbimet financiare përfaqësojnë një mbështetje të konsiderueshme të ekonomisë dhe përbëjnë sektorin më të shpejtë të rritjes në këtë vend. Më 17 Maj 2007, Grupi Financiar ICB AG Holding u listua në tregun AIM të Bursës në Londër.

Banka përfiton nga mbështetja e fortë e Grupit përsa i përket referimit të klientëve dhe bizneseve. Synimi i përgjithshëm për ICB-në është forcimi dhe zgjerimi i mëtejshëm i pozicionit të saj si një subjekt bankar.

Të vendosur për përmirësimin në vazhdimësi të pjesës së saj në tregun e Sistemit Bankar Shqiptar, menaxhmenti i bankës garanton një shërbim të vazhdueshëm dhe cilësor për klientët e saj duke i ofruar atyre nivelin më të lartë të shërbimeve financiare.

DREJTOR EKZEKUTIV: Z. MAHENDRA SINGH RAWAT

TË DHËNA PËRMBLEDHËSE MË 31.12.2009:

	Milionë Lekë	Mijë EURO		
<b>Mjetet</b>	6,747.8	48,911	<b>Nr. i degëve dhe agjencie</b>	<b>8</b>
<b>Huatë</b>	2,187.9	15,859		
Huatë për Biznese	1,609.9	11,669	<b>Nr. i punonjësve</b>	<b>71</b>
Huatë për Individë	578.0	4,189		
<b>Kapitali Aksioner</b>	1,334.3	9,672	<b>Struktura e Aksionerëve:</b>	
<b>Depozitat</b>	4,626.8	33,537		
Depozitat e Bizneseve	1,759.2	12,751	ICB Financial Group	100%
Depozitat e Individëve	2,867.6	20,786		
<b>Fitimi Neto</b>	120.5	874		

Të dhëna të Audituar sipas IFRS; 1 EURO = 137.96 Lekë

## PAMJE E PËRGJITHSHME

Banka Intesa SanPaolo – Shqipëri është bankë e grupit Intesa Sanpaolo. Ky grup është ndër grupet kryesorë bankar të Euro Zonës dhe lider në Itali në shërbim të biznesit të vogël, korporatave dhe në administrimin rajoneve të pasura të biznesit. Në sajë të rrjetit të zgjeruar prej rreth 6000 degëve ofron një rang të gjerë shërbimesh për rreth 11.1 milion klientë në Itali. Aktivitetet ndërkombëtare të Intesa Sanpaolo janë të fokusuara në Evropën Qendrore dhe Lindore dhe në gjirin e Mesdheut, ku operon nëpërmjet bankave tregtare në 13 shtete me përafërsisht 1900 degë dhe u shërben 8.5 milion klientëve. Për më tepër, një rrjet ndërkombëtar është prezent në 34 shtete për të mbështetur klientelën e kompanisë. Grupi ofron soliditetin historik të trashëguar prej shekujsh, lidërsip ndërkombëtar dhe një kombinimin të spikatur të veprimtarisë së tij të ndërthurur me traditat lokale. Gjatë vitit 2009 grupi shfaq një produktivitet të qëndrueshëm, një pozicion të fortë likuiditeti dhe një profil me risk të ulët.

Banka Intesa Sanpaolo e Shqipërisë, u prezantua zyrtarisht me emrin e saj të ri më 13 Tetor 2008, rezultat ky i shkrijës së Bankës Amerikane të Shqipërisë (1998) dhe Bankës Italo-Shqiptare (1993).

Misioni i saj është të mbështesë zhvillimin e shtetit dhe mirëqenien e familjeve shqiptare duke u udhëhequr nga parimet e saj të integritetit, cilësisë, transparencës, respektimit të vlerave të veçanta, barazisë, vlerave të individëve dhe përgjegjshmërisë në përdorimin e burimeve. Banka Intesa Sanpaolo Shqipëri kryen aktivitetet e saj në përputhje me Kodin e Etikës së vetë Grupit.

DREJTOR EKZEKUTIV: Z. STEFANO FARABBI

TË DHËNA PËRMBLEDHËSE MË 31.12.2009:

	Milionë Lekë	Mijë EURO		
<b>Mjetet</b>	114,384.8	829,115	<b>Nr. i degëve dhe agjencive</b>	<b>36</b>
<b>Huatë</b>	49,685.8	360,146		
Huatë për Biznese	38,727.3	280,714	<b>Nr. i punonjësve</b>	<b>513</b>
Huatë për Individë	10,958.5	79,432		
<b>Kapitali Aksioner</b>	10,991.0	79,668	<b>Struktura e Aksionerëve:</b>	
<b>Depozitat</b>	97,427.5	706,201		
Depozitat e Bizneseve	24,294.0	176,095	Intesa Sanpaolo Group S.p.A.	90.83%
Depozitat e Individëve	73,133.5	530,106	BERZH	7.78%
<b>Fitimi Neto</b>	1,618.2	11,730	Società Italiana per le Imprese all'Estero S.p.A.	1.39%
Të dhëna të Audituaras sipas IFRS; 1 EURO = 137.96 Lekë				



**NBG Bank**

**BANKA KOMBËTARE E GREQISË – SHQIPËRI  
THEMELUAR NË SHQIPËRI NË VITIN 1996**

## PAMJE E PËRGJITHSHME

Banka Kombëtare e Greqisë në Shqipëri (NBG në Shqipëri) është pjesë e Grupit NBG, grupi financiar më i madh në Ballkan dhe Evropën Jug-Lindore, me fitim neto pas taksës afërsisht 1 miliardë Euro në vitin 2009 dhe kapitalizim shumë të mirë. NBG në Shqipëri u shërben klientëve të saj prej 13 vjetësh në të gjithë vendin. Ajo ofron një gamë të plotë produktesh dhe shërbimesh bankare për klientët e të gjithë segmenteve: korporata të mëdha, biznese të vogla dhe të mesme, dhe individë me një staf të dedikuar në të gjitha degët, përgjegjës për individët dhe bizneset.

NBG në Shqipëri filloi aktivitetin e saj në Nëntor 1996. Që atëherë ajo e ka zgjeruar rrjetin me 30 degë, 12 nga të cilat në Tiranë, dhe 18 të tjerat në çdo qytet të Shqipërisë. NBG në Shqipëri ka një rrjet ATM-sh në të gjithë vendin duke mundësuar për të gjithë klientët e saj akses në fondet e tyre kudo që të jenë pa pasur nevojë të shkojnë në bankë.

NBG në Shqipëri kujdeset për stafin e saj dhe investon çdo vit në trajnime për të përmirësuar aftësitë dhe profesionalizmin e punonjësve të saj. Gjatë këtyre viteve ajo ka përmirësuar shumë nivelin e shërbimit ndaj klientit. NBG në Shqipëri merr shumë seriozisht përgjegjësinë e saj sociale. Ndërkohë që tregon përgjegjshmëri ndaj ambientit ajo mbështet me projekte të ndryshme sociale komunitetin në të cilin punon.

DREJTOR EKZEKUTIV: Z. IOANNIS KOUGIONAS

TË DHËNA PËRMBLEDHËSE MË 31.12.2009:

	Milionë Lekë	Mijë EURO		
<b>Mjetet</b>	44,346.5	321,445	<b>Nr. i degëve dhe agjencie</b>	<b>30</b>
<b>Huatë</b>	39,032.4	282,925		
Huatë për Biznese	18,011.3	130,554	<b>Nr. i punonjësve</b>	<b>307</b>
Huatë për Individë	21,021.2	152,371		
<b>Kapitali Aksioner</b>	6,352.0	46,042	<b>Struktura e Aksionerëve:</b>	
<b>Depozitat</b>	22,934.8	166,243		
Depozitat e Bizneseve	21,248.7	154,021	National Bank of Greece S.A.	100%
Depozitat e Individëve	1,686.1	12,222		
<b>Fitimi Neto</b>	12.7	92		
Të dhëna të Audituar sipas IFRS; 1 EURO = 137.96 Lekë				

## PAMJE E PËRGJITHSHME

ProCredit Bank Shqipëri u themelua në vitin 1995 si “Fondacioni për Sipërmarrje, Financë dhe Zhvillim” (FEFAD), ku 100% e kapitalit aksioner sigurohej nga KfW. Fokusi i institucionit ishte të siguronte mundësi financimi për bizneset shqiptare të vogla dhe shumë të vogla. Pavarësisht nga trazirat politike dhe ekonomike në vend, në vitin 1997 FEFAD-i arriti të ketë një performancë financiare të suksesshme dhe mori licencën bankare në vitin 1999, duke u kthyer kështu në FEFAD Bank. Aksionerët themelues të bankës ishin Fondacioni FEFAD, ProCredit Holding (atëherë e njohur si IMI), Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (EBRD), si dhe Korporata Ndërkombëtare Financiare. Këtyre aksionerëve iu bashkua edhe Commerzbank AG në vitin 2002. Në vitin 2003, institucioni mori emrin “ProCredit Bank”, duke reflektuar në këtë mënyrë lidhjen me grupin ProCredit. Përgjatë viteve, ProCredit Holding forcoi edhe më tej pozicionin e saj në bankë duke blerë aksionet e EBRD-së.

Aktualisht dy aksionerët e ProCredit Bank në Shqipëri janë ProCredit Holding dhe Commerzbank AG. ProCredit Holding është kompania mëmë e grupit global të 22 bankave ProCredit. ProCredit Holding u themelua si Internationale Micro Investitionen AG (IMI) në vitin 1998 nga kompania pioniere për këshillim financiar, IPC. ProCredit Holding është një partneritet me pronësi publike dhe private.

ProCredit Holding ka si qëllim të zgjerojë mundësinë për shërbime financiare në vendet në zhvillim dhe ekonomitë në tranzicion, duke ndërtuar një grup bankash që janë lider në sigurimin e shërbimeve financiare të paanshme dhe transparente për bizneset e vogla dhe të mesme, si dhe për popullatën e përgjithshme në vendet ku ato veprojnë.

DREJTOR EKZEKUTIV: Z. BORISLAV KOSTADINOV

TË DHËNA PËRMBLEDHËSE MË 31.12.2009:

	Milionë Lekë	Mijë EURO		
<b>Mjetet</b>	41,231.4	298,865	<b>Nr. i degëve dhe agjencive</b>	<b>42</b>
<b>Huatë</b>	20,576.9	149,151		
Huatë për Biznese	8,168.2	59,207	<b>Nr. i punonjësve</b>	<b>867</b>
Huatë për Individë	12,408.7	89,944		
<b>Kapitali Aksioner</b>	5,154.6	37,363	<b>Struktura e Aksionerëve:</b>	
<b>Depozitat</b>	33,781.3	244,863		
Depozitat e Bizneseve	3,425.0	24,826	ProCredit Holding AG	80%
Depozitat e Individëve	30,356.3	220,037	CommerzBank AG	20%
<b>Fitimi Neto</b>	196.8	1,491		
Të dhëna të Audituarra sipas IFRS				
Fund periodhe I EURO = 137.96 Lekë; Fitimi neto me kurs mesatar I EURO = 132.04 Lekë				



RAIFFEISEN BANK – SHQIPËRI  
THEMELUAR NË SHQIPËRI NË VITIN 1991

## PAMJE E PËRSGJITHSHME

Raiffeisen Bank Shqipëri është banka më e madhe në vend me një total asetesh prej rreth 2 miliardë Euro. Raiffeisen International bleu Bankën e Kursimeve në Shqipëri në 2004 dhe gjatë 5 viteve të kaluara e ka transformuar plotësisht Bankën e vjetër Shtetërore në një bankë me shërbime të plota që i shërben të gjithë sektorëve të biznesit dhe klientëve individë. Portofoli i kredisë është rritur nga zero që ishte në 2004 në 680 milion Euro në fund të vitit 2009. Transformimi tani ka përfunduar dhe Banka ofron një gamë produktesh, procesesh, sistemesh dhe infrastrukturë degësh që krahasohen me standardet Evropiane të shekullit 21-të.

Raiffeisen Bank Shqipëri disponon rjetin më të gjerë me 102 degë në të gjithë vendin, 180 Bankomate, 1,200 terminale shitjesh (POS) dhe më shumë se 150,000 Karta Debiti Visa Electron të hedhura në treg. Ndërkohë, më shumë se 140,000 persona marrin pagën e tyre nëpërmjet Raiffeisen Bank.

Raiffeisen Bank në Shqipëri ofron një gamë të gjerë produktesh dhe shërbimesh në sektorët kyç të biznesit – klientët individë, tregjet e Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme (SME) dhe korporatat. Me dhënien e kredisë klientëve korporatë dhe ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, me trajnimin intensiv të stafit dhe ofrimin e produkteve të reja bankare, Raiffeisen Bank e ka përforcuar pozicionin e saj udhëheqës në treg. Kjo përfshin të gjitha format e huasë, financimit me leasing, shërbimet bankare për të punësuarit, kredi dhe overdrifte, dhe shërbime bankare on-line në kohë reale nëpërmjet Multi Cash, një shërbim i bazuar në Internet dhe udhëheqës në treg.

DREJTOR EKZEKUTIV: Z. OLIVER WHITTLE

TË DHËNA PËRMBLEDHËSE MË 31.12.2009:

	Milionë Lekë	Mijë EURO		
<b>Mjetet</b>	251,760.7	1,824,882	<b>Nr. i degëve dhe agjencive</b>	<b>102</b>
<b>Huatë</b>	93,410.0	677,081		
Huatë për Biznese	71,335.7	517,075	<b>Nr. i punonjësve</b>	<b>1,362</b>
Huatë për Individë	22,074.4	160,006		
<b>Kapitali Aksioner</b>	24,366.4	176,619	<b>Struktura e Aksionerëve:</b>	
<b>Depozitat</b>	207,562.0	1,504,508		
Depozitat e Bizneseve	18,747.8	135,893	Raiffeisen International Bank AG	100%
Depozitat e Individëve	188,814.2	1,368,616		
<b>Fitimi Neto</b>	4,621.3	35,017		
Të dhëna të Audituar sipas IFRS				
Fund periudhe 1 EURO = 137.96 Lekë; Fitimi neto me kurs mesatar 1 EURO = 131.98 Lekë				

## PAMJE E PËRGJITHSHME

Tirana Bank është banka e parë me kapital privat që nisi të operojë në Shqipëri. Ajo u themelua në vitin 1996 duke ofruar të gjitha shërbimet bankare e duke shtrirë degët e saj në të gjithë Shqipërinë.

Tashmë, pas 14 vitesh në tregun Shqiptar, Tirana Bank është konsoliduar dhe ofron një larmishmëri produktesh dhe shërbimesh të përshtatura për nevojat e klientëve të saj. Aktualisht, Tirana Bank numëron 50 degë dhe një rrjet të gjerë automatesh në të gjithë vendin si dhe punëson rreth 500 punonjës.

Tirana Bank është anëtare e Grupit Bankar të Pireut, i cili është prezent ne Greqi, Serbi, Bullgari, Rumani, Ukrainë, Qipro, Egjipt, Nju Jork dhe një degë në Londër, Angli. Tirana Bank ndan me Grupin të njëjtin vizion e objektiva me qëllim të qëndrojë lider në treg me shërbimet e saj financiare. Tirana Bank vazhdon të rritet me shpejtësi duke zënë vendin e dytë për sa i takon kredidhënies me 12.9 % pjesë të tregut dhe e katërta në totalin e depozitave me 8.0 % të tregut. Shumë kompani gjejnë tek Tirana Bank një bashkëpunëtor të qëndrueshëm që i ndihmon dhe mbështet në biznes.

Objektivi kryesor i Tirana Bank është të mbetet një lider në tregun Shqiptar dhe të jetë e para në ofrimin e shërbimeve inovative për individët dhe bizneset, duke qenë kështu më afër klientëve të vet dhe duke gjetur zgjidhje të personalizuar për kërkesat e tyre.

DREJTOR EKZEKUTIV: Z. DIMITRIS SANTIXIS

TË DHËNA PËRMBLEDHËSE MË 31.12.2009:

	Milionë Lekë	Mijë EURO		
<b>Mjetet</b>	84,641.4	613,521	<b>Nr. i degëve dhe agjencive</b>	<b>47</b>
<b>Huatë</b>	59,214.6	429,215.8		
Huatë për Biznese	42,377.0	307,169	<b>Nr. i punonjësve</b>	<b>460</b>
Huatë për Individë	16,837.6	122,047		
<b>Kapitali Aksioner</b>	11,707.3	84,860	<b>Struktura e Aksionerëve:</b>	
<b>Depozitat</b>	55,686.6	403,643.3		
Depozitat e Bizneseve	9,584.4	69,472	Piraeus Bank	97%
Depozitat e Individëve	46,102.2	334,171	Dafnila S.A	1%
<b>Fitimi Neto</b>	1,790.8	12,980	Z. Tzivelis Ioannis	2%

Të dhëna të Audituar sipas IFRS; 1 EURO = 137.96 Lekë





UNION BANK  
THEMELUAR NË SHQIPËRI NË VITIN 2006

## PAMJE E PËRQJITHSHME

Union Bank filloi aktivitetin e saj bankar në Janar 2006, sipas Licencës së lëshuar nga Banka e Shqipërisë për të ushtruar veprimtari bankare në Republikën e Shqipërisë. Ajo u themelua si një bankë private me kapital 100% shqiptar dhe lindi nga njëri prej Institucioneve më të suksesshëm të sistemit financiar shqiptar – Unioni Financiar Tiranë sh.p.k., përfaqësues i Western Union Financial Services Inc. për Shqipërinë, Kosovën dhe Maqedoninë.

Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) bleu në vitin 2008 12.5 për qind të aksioneve të kapitalit të Union Bank, për të mbështetur më tej zhvillimin e aktivitetit të kredihënies së bankës, dhe strategjinë e saj për rritjen e shpejtë jo vetëm në Shqipëri por edhe në vendet fqinjë. Kështu, BERZH u bë pjesë e përpjekjeve të vazhdueshme të Union Bank për ta shndërruar atë në bankën më të dashur për klientët.

Që prej themelimit të saj, Banka është rritur në mënyrë të vazhdueshme e të qëndrueshme, dhe ka shtuar vlerat e saj duke ndjekur e përmirësuar eksperiencën pozitive të trashëguar nga institucionet aksionere të saj. Tashmë, me një rrjet prej 31 degësh të shtrirë në rrethet kryesore të vendit, ajo ofron një gamë të kompletuar të produkteve dhe shërbimeve bankare, si për individët ashtu edhe për sektorin e bizneseve.

Synimet e stafit të Bankës janë përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë së Shërbimit, duke u gjendur nëpërmjet një komunikimi intensiv, gjithmonë pranë Klientit Ekzistues dhe Potencial.

DREJTOR EKZEKUTIV: Z. GAZMEND KADRIU

TË DHËNA PËRMBLEDHËSE MË 31.12.2009:

	Milionë Lekë	Mijë EURO		
<b>Mjetet</b>	16,743.5	121,365	<b>Nr. i degëve dhe agjencie</b>	<b>31</b>
<b>Huatë</b>	9,977.4	72,321.0		
Huatë për Biznese	7,915.1	57,372	<b>Nr. i punonjësve</b>	<b>236</b>
Huatë për Individë	2,062.3	14,949		
<b>Kapitali Aksioner</b>	1,881.1	13,635	<b>Struktura e Aksionerëve:</b>	
<b>Depozitat</b>	12,597.3	91,311.1	Unioni Financiar Tiranë sh.p.k	83.12%
Depozitat e Bizneseve	4,147.8	30,065	BERZH	12.5%
Depozitat e Individëve	8,449.5	61,246	Z. Niko LEKA	2.19%
<b>Fitimi Neto</b>	117.1	849	Z. Edmond LEKA	2.19%
Të dhëna të Audituar sipas IFRS; 1 EURO = 137.96 Lekë				

## PAMJE E PËRGJITHSHME

Banka e Bashkuar e Shqipërisë (UBA) ka filluar aktivitetin e saj si një nga bankat tregtare në Shqipëri që në Maj 1993. Banka u themelua nga Banka Kombëtare Tregtare e Shqipërisë (40%) e cila ishte në pronësi të shtetit, dhe një grup institucionesh prestigjioze financiare. Pas privatizimit të BKT-së, në vitin 2000, 40% e aksioneve u transferuan në Ministrinë e Financave të Shqipërisë.

Në mars të vitit 2009, Banka ndryshoi strukturën e tij aksionare, nëpërmjet shitjes së aksioneve të zotëruara nga Ministria e Financave Bankës Islamike për Zhvillim (IDB), që është një ndër institucionet e mëdha ndërkombëtare financiare me një kapitali tënënshkruar prej 20 miliard dollarësh. Qëllimi i IDB-së është të nxisë zhvillimin ekonomik dhe progresin shoqëror të vendeve anëtare. Që prej kohësh, IDB është e pranishme në Shqipëri nëpërmjet projekteve të saj të financimit në projekte të infrastrukturës dhe bujqësisë, si rrugët, kanalet, digat, shkollat, ujësjellësit, spitalet, strehimin, zhvillimin rural, etj..

UBA zhvillon aktivitetin e saj në Shqipëri nëpërmjet Degëve të saj në Tiranë, Shkodër, Fier dhe Durrës, dhe dy agjencive të vendosura në Tiranë, me perspektivë për të hapur degë të reja në Tiranë dhe rrethe të tjera të Shqipërisë. Nëpërmjet personelit të trajnuar dhe të kualifikuar, me përvojë të gjatë ndërkombëtare dhe lokale, mbështetur nga një sistem kompjuterik i avancuar, banka ofron shërbime të shpejta, efikase dhe profesionale të tilla si: transfertat brenda dhe jashtë vendit, llogaritë rrjedhëse dhe të investimit me norma konkurruese, financim për banim dhe biznes, letra kredie dhe garanci, transaksioneve të këmbimit valutor, çeqe bankar e personal, pagesat në llogaritë e Buxhetit të Shtetit, pagesën e faturave të shërbimeve, etj..

DREJTOR EKZEKUTIV: Z. HIKMET GULER

TË DHËNA PËRMBLEDHËSE MË 31.12.2009:

	Milionë Lekë	Mijë EURO		
<b>Mjetet</b>	4,929.4	35,730	<b>Nr. i degëve dhe agjencive</b>	<b>6</b>
<b>Huatë</b>	2,032.2	14,730.4	<b>Nr. i punonjësve</b>	<b>96</b>
Huatë për Biznese	1,756.9	12,735	<b>Struktura e Aksionerëve:</b>	
Huatë për Individë	275.3	1,996	Islamic Development Bank	55%
<b>Kapitali Aksioner</b>	1,140.0	8,263	Shamil Bank of Bahrain (E.C.)	20%
<b>Depozitat</b>	3,534.3	25,618.5	Dallah Albaraka Holding Co.	10%
Depozitat e Bizneseve	724.0	5,248	Business Focus SDN BHD	6.34%
Depozitat e Individëve	2,810.4	20,371	Saudi Brothers Commercial Co.	3%
<b>Fitimi Neto</b>	(92.4)	(670)	Individuals (7 ps)	6.17%
Të dhëna të Pa-Audituar sipas Standardeve Lokale; 1 EURO = 137.96 Lekë				



VENETO BANKA  
THEMELUAR NË SHQIPËRI NË VITIN 2005

## PAMJE E PËRSGJITHSHME

Veneto Banka është themeluar në vitin 2005, pas blerjes 100% të aksioneve të ish-Bankës Dardania nga familja Mariano, duke u bërë kështu e vetmja bankë me tërësisht kapital italian në Shqipëri.

Veneto Banka në vitin 2008 u bë pjesë e Gruppo Veneto Banca, i cili zotëron 100% të kapitalit të këtij instituti. Gruppo Veneto Banca është një nga 15 grupet kryesore bankare italiane dhe kjo vjen si rezultat i ecurisë së mirë të një procesi i cili daton me vitin 1877, vit në të cilin krijohet Banca Popolare di Montebelluna. Që nga viti 1997, nis një udhëtim që e çon në ndryshimin e emrit të saj në Veneto Banca dhe kthimin në protagonistë të panoramës kombëtare bankare italiane. Zgjerimi i interesit më pas vazhdoi edhe në Evropën Lindore, me Banca Italo-Romena në Rumani, EximBank në Moldavi, Gospodarsko Kreditna Banka e cila më pas u quajt Veneto Banka Kroazia në Kroaci, si dhe me Bankën Italiane të Zhvillimit, e riemërtuar më pas si Veneto Banka Albania, në Shqipëri.

Misioni i Gruppo Veneto Banca është që të jetë një grup novator dhe autonom, udhëheqës në territoret që ai përfshin, i aftë për të ofruar shërbime cilësore dhe për të gjeneruar, me etikë dhe përgjegjësi, vlerë në kohë për anëtarët, klientët dhe punonjësit e tij.

Me një rrjet prej 8 filialesh, të shtrira në qarqet më kryesore të vendit, Veneto Banka operon kryesisht me bizneset e vogla dhe të mesme, si një mbështetës i fuqishëm si për prodhuesit shqiptarë, ashtu dhe për bizneset e sipërmarrjet italiane - tanimë më shumë se 500 - të cilat e kanë zgjedhur Shqipërinë për të bërë biznes.

DREJTOR EKZEKUTIV: Z. LIBERO CATALANO

TË DHËNA PËRMBLEDHËSE MË 31.12.2009:

	Milionë Lekë	Mijë EURO		
<b>Mjetet</b>	5,826.2	42,231	<b>Nr. i degëve dhe agjencie</b>	<b>8</b>
<b>Huatë</b>	3,742.4	27,126.7		
Huatë për Biznese	3,117.7	22,599	<b>Nr. i punonjësve</b>	<b>68</b>
Huatë për Individë	624.7	4,528		
<b>Kapitali Aksioner</b>	1,668.7	12,095	<b>Struktura e Aksionerëve:</b>	
<b>Depozitat</b>	4,099.4	29,714.7		
Depozitat e Bizneseve	2,144.6	15,545	Veneto Banca Holding	100%
Depozitat e Individëve	1,954.9	14,170		
<b>Fitimi Neto</b>	29.6	215		

Të dhëna të Audituar sipas IFRS; 1 EURO = 137.96 Lekë

